



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme”
ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli

Dr. Niko Hyka

Janar / 2024

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË
STUDIMIT Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme”**

1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 685, datë 25.08.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati Nr.94, datë 14.06.2018 miratuar nga MASR me shkresë Nr 7239/1, datë 17.08.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 320, datë 22.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditohet për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli I-rë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 Vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	18/30 (38%/62%)
18	Numri i studentëve:	2019 – 2020 109 studentë 2020 – 2021 148 studentë 2021 – 2022 128 studentë
19	Komente / të tjera:	-




PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës është një Institucion publik i Arsimit të Lartë i krijuar me VKM Nr. 801, datë 20.12.2005 dhe akredituar me VBA nr. 18, datë 24.03.2022. IAL ka 5 Njësi Kryesore, 22 Njësi Bazë dhe 3 Qendra Kërkimore Shkencore. Programi i studimit “Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme”, është një program studimi i cili ofrohet nga Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore, në Fakultetin e Studimeve Profesionale, në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës. Fakulteti i Studimeve Profesionale është hapur me VKM, Nr. 685, dt.25.08.2010, si një nga njësitë kryesore të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD). Ky program studimi kalon procesin e akreditimit për herë të parë. Fakulteti i Studimeve Profesionale ka në përbërjen e vet:

1. Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë;
2. Departamenti i `Shkencave Teknike Mjekësore`;
3. Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe të Natyrës;
4. Departamenti i Studimeve të Integruara me Praktikën;

Fakulteti i Studimeve Profesionale ofron programet e mëposhtme:

Programe profesionale (2-vjeçare – 120 ECTS);

Menaxhim Ndërtimi, Hidroteknikë Ujësjiellës-Kanalizime, Teknikë Elektrike, Menaxhim Transporti Detar/Tokësor, Teknologji Automobilitash, Specialist Rrjetash Kompjuterike, Informatikë Praktike, Asistent Ligjor, Asistent Administrativ, Ndihmës Dentist.

Programe të Ciklit të Parë të Studimit (Bachelor -180 ECTS);

“Navigacion dhe Menaxhim Detar”, “Infermieri e Përgjithshme”, “Fizioterapi”, “Mami”.

Programe të Ciklit të Dytë të Studimit;

Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”

Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore të Fakultetit të Studimeve Profesionale ka në përbërjen e vet 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë me kohë të plotë. Vetëm 1 (një) prej këtyre ka titullin Profesor ndërsa pjesa tjetër e Njësisë Bazë janë me titullin Dr. 8 (tetë) si dhe 3 (tre) me specializim afatgjatë në Mjekësi dhe 3 (tre) me Master Shkencor. Ky program studimi ofrohet që prej vitit 2010 bazuar në VKM Nr. 685, datë 25.08.2010 si dhe është riorganizuar në vitin 2018 bazuar në Vendimin e Senatit Akademik Nr.94, datë 14.06.2018 miratuar nga MASR me shkresën Nr 7239/1, datë 17.08.2018.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme” që ofrohet nga Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore të Fakultetit të Studimeve Profesionale në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, filloi me marrjen e dokumentacionit të ofruar nga intitucioni, si dhe ndarjen e punës për përgatitjen e pyetjeve dhe kërkesave për dokumentacion shtesë. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UAMD, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Në kuadër të procesit të jashtëm të vlerësimit është përgatitur agjenda nga ASCAL dhe është kryer vizita në datat 3-4 Korrik 2023. Dy ekspertët e përzgjedhur shoqëroheshin nga një specialist i ASCAL. Grupi i vlerësimit të jashtëm kishte në përbërje Dr. Niko Hyka dhe Prof. As. Enkelejd Mëhilli. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm, ky grup pune u asistua edhe nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, Znj. Aleksandra Xhamo.

Bazuar në agjendën e përgatitur nga ASCAL u zhvilluan takimet me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe të Njesisë Bazë, grupin e vlerësimit të brendshëm, anëtarë të stafit akademik dhe studentët. Duke patur parasysh që GVB si dhe stafi akademik ishin të njëjtit persona u vendos që të zhvillohej një takim dhe jo dy të ndryshëm. Paralelisht, u zhvillua vizita në sekretarinë mësimore si dhe në ambientet e Fakultetit. Gjatë vizitës në Institucion u panë klasa, laboratorë të ndryshëm si dhe biblioteka. Kohëzgjatja e takimeve ishte ajo e parashikuara.

GVJ zhvilloi takime me përfaqësues të Sektorit të Karrierës, Alumni dhe Komunikimit, përfaqësues së Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë, Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe përfaqësues së Sektorit të Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve. Me përfundimin e takimeve, GVJ takoi Drejtuesin e Departamentit ndërsa eksperti i ASCAL do të informonte koordinatorin Institucional mbi disa dokumenta shtesë. Në përfundim të vizitave, ekspertët në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, takimeve të zhvilluara si dhe vizitës në ambientet e Institucionit hartuan Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.



Më datë 11.01.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 19/2 Prot., datë 12.01.2024, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 17.01.2024, dhe me shkresë zyrtare Nr. 105 Prot., datë 16.01.2024, institucioni ka dërguar komente mbi draft raportin.

Pasi shqyrtuam komentet e ardhura nga institucioni ne si ekspertë të jashtëm konkludojmë që institucioni është i dakortësuar me draft raportin e vlerësimit të jashtëm (DRVJ) prandaj gjykojmë që ky draft dërgohet tani nga ana jonë si Raport i Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme” në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Infermieri e Përgjithshme”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi i studimit Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme”, është një program studimi i cili ofrohet nga Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore, në Fakultetin e Studimeve Profesionale, në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës. Ky program studimi është në harmoni me interesat kombëtare si dhe misionin dhe objektivat e IAL-së. Programi ofrohet në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Shëndetësinë si dhe Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin, 2017- 2022. Paralelisht, ky program studimi ofrohet në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, me Statutin dhe Rregulloren e IAL-së si dhe me Rregulloren e Njësisë Kryesore dhe Njësisë Bazë.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 02 Strategjia Kombëtare Për Shëndetësinë, VKM nr 439, datë 17.05.2017;</i></p> <p><i>Nr. 03 Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin, 2017- 2022;</i></p> <p><i>Nr 04 Statuti i UAMD, neni 3, 4, 7, 82, 84, 94;</i></p> <p><i>Nr. 08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale;</i></p> <p><i>Nr. 09 Rregullore e Departamentite Shkencave Teknike Mjekësore;</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Ky program studimi është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e UAMD. Nenet 3 dhe 4 të Statutit të UAMD përcaktojnë qartë misionin dhe qëllimet e Institucionit. Sipas planit të Zhvillimit të IAL-së, UAMD synon të karakterizohet gjithnjë e më shumë si një qendër akademike cilësore dhe inovatore, si një realitet i ri dhe dinamik duke ofruar një alternativë serioze në panoramën e Arsimit të Lartë. Vizioni që propozohet është ai i një Universiteti të lirë dhe autonom, pararojë në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor, i aftë të udhëheqë studentët në mënyrë të përgjegjshme duke kontribuar denjësisht në tregun e punës, i aftë të influencojë</p>



	<p>botën akademike dhe të përballojë sfidat e bashkësisë shkencore ndërkombëtare. Misioni i Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës është që të rris prestigjin dhe të sjell shkencë dhe punësim, nëpërmjet ofrimit të programeve të studimit në të tre ciklet e studimit, të studuarit gjatë gjithë jetës, aftësimi të personelit akademik, duke e bërë UAMD-në një qendër nevralgjike të zhvillimit të dijes, inovacionit dhe ekonomisë. Programi i studimit Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme” ofrohet në përputhje me fushën e veprimtarisë së IAL-së. Rregullorja e Programit të studimit është hartuar në përputhje me objektivat e programit përkatës të studimit, me planin e tij mësimor si dhe me veprimtaritë mësimore të tij.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 04 Statuti i UAMD, neni 3 ;</i></p> <p><i>Nr. 06 Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025;</i></p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e programi të studimit Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme”</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Ky program studimi është hartuar dhe ofrohet në përshtatje me fushat dhe drejtimet e Institucionit si dhe në bazë të akteve dhe vendimeve të brendshme të tij. Sipas planit strategjik UAMD, ka si mision të kryej mandatin e tij arsimor dhe shkencor në mënyrë të kënaqshme dhe në hap me kohën, të promovojë Arsimin e Lartë duke shkëmbyer njohuri dhe duke gjeneruar ide të reja dhe moderne, të promovojë dhe mbështesë projekte inovative kërkimore që inkurajojnë dhe forcojnë lidhjen midis tregut të punës dhe Universitetit, të garantojë mundësi të barabarta për stafin akademik në përfitimet e financimeve për kërkim shkencor. Formimi, zhvillimi dhe trasmetimi i dijeve mbetet objektiv kryesor, me qëllim aftësimin e studentëve tanë për transformimin e tyre personal, suksesin profesional dhe përmirësimin e të mirave të përbashkëta, nëpërmjet një mjedisi dinamik, pro angazhimit në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie dhe gjithëpërfshirje në kërkimin shkencor, nëpërmjet ofrimit të hapësirave për më shumë komunikim, diskutim të lirë dhe të gjallë, në respekt të ndërsjelltë për formimin me bindje individuale, si akselerues i angazhimit social-komunitar. Nenet 3 dhe 4 të Statutit të UAMD përcaktojnë qartë misionin dhe qëllimet e Institucionit. Njësia Kryesore mbështet prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit, nëpërmjet formimit të studentëve si specialistë të profesioneve të ndryshme dhe përgatitja e tyre në përputhje me prioritetet e zhvillimit dhe kërkesat e tregut të punës. Rregullorja e UAMD ka si qëllim të siguroj kuadrin e</p>

	<p>brendshëm rregullator të nevojshëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë mësimore, kërkimore-shkencore dhe administrative.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 04 Statuti i UAMD, neni 3;</i></p> <p><i>Nr. 05 Rregullorja UAMD neni 3;</i></p> <p><i>Nr. 06 Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025;</i></p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e programi të studimit Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme”;</i></p>																														
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>UAMD është krijuar me VKM Nr. 801, datë 20.12.2005. Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore të Fakultetit të Studimeve Profesionale ka në përbërjen e vet 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë me kohë të plotë. Vetëm 1 (një) prej këtyre ka titullin profesor ndërsa pjesa tjetër e Njesisë Bazë kanë titullin Dr. 8 (tetë) si dhe 3 (tre) me specializim afatgjatë në Mjekësi dhe 3 (tre) me Master Shkencor. Ky program studimi ofrohet që prej vitit 2010 bazuar në VKM Nr. 685, datë 25.08.2010 si dhe është riorganizuar në vitin 2018 bazuar në Vendimin e Senatit Akademik Nr.94, datë 14.06.2018 miratuar nga MASR me shkresën Nr 7239/1, datë 17.08.2018.</p> <p>Në tabelat shoqëruese të RVB si dhe CV e personelit akademik jepet një informacion i detajuar mbi numrin dhe cilësitë e personelit akademik të përfshirë në programin e studimit Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme”.</p> <table border="1" data-bbox="603 1361 1374 1928"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Viti akademik</th> <th colspan="2">PAE</th> <th colspan="2">PAK</th> </tr> <tr> <th>Nr.</th> <th>Titulli/Grada</th> <th>Nr.</th> <th>Titulli/Grada</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td rowspan="5">2019-2020</td> <td>1</td> <td>Prof.Dr.</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>11</td> <td>Dr.</td> <td>5</td> <td>Dr.</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>(PhD/Dr. në proçes)</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Msc.</td> <td>12</td> <td>Msc.</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Msc.Spa</td> <td>12</td> <td>Msc.Spa</td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	PAE		PAK		Nr.	Titulli/Grada	Nr.	Titulli/Grada	2019-2020	1	Prof.Dr.			11	Dr.	5	Dr.	2	(PhD/Dr. në proçes)			2	Msc.	12	Msc.	2	Msc.Spa	12	Msc.Spa
Viti akademik	PAE		PAK																												
	Nr.	Titulli/Grada	Nr.	Titulli/Grada																											
2019-2020	1	Prof.Dr.																													
	11	Dr.	5	Dr.																											
	2	(PhD/Dr. në proçes)																													
	2	Msc.	12	Msc.																											
	2	Msc.Spa	12	Msc.Spa																											




	2020-2021	1	Prof.Dr.		
		11	Dr.	6	Dr.
		2	(PhD/Dr. në proçes)	2	(Dr. në proçes)
				6	Msc.
		2	Msc.	9	Msc.Spa
		2	Msc.Spa		
	2021-2022	1	Prof.Dr.		
		2	Prof.As.		
		11	Dr.	6	Dr.
		1	(Dr. në proçes)	2	(Dr. në proçes)
		1	Msc.	10	Msc.
		2	Msc.Spa.	7	Msc.Spa.
	<p>GVJ konsideron të rëndësishme që të rritet numri i anëtarëve të stafit akademik me tituj akademik dhe grada shkencore.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.76 Stafi Akademik i Departamentit të Shkencave Teknike Mjekësore gjatë 3 viteve të fundit akademike (2019 – 2022);</i></p> <p><i>Nr.121 Dosja e Programit të studimit me të gjithë elementët përbërës;</i></p>				
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të	Fusha e përgjithshme si dhe fusha specifike e programit të studimit Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme” është në përputhje me fushën akademike të Njësisë Kryesore dhe Bazë që ofrojnë këtë program studimi. Njësia Kryesore (Fakulteti i Studimeve Profesionale) e cila ofron këtë program studimi ka në përbërje të saj 4 Njësi Bazë (Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë, Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe të Natyrës, Departamenti i Studimeve të Integruara me Praktikën dhe Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore).				

<p>programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Sipas nenit 9 të Rregullores së Njesisë Bazë, ky Departament ka si qëllim mësimdhënien dhe punën kërkimore shkencore në fusha kërkimi të përafërta me fushën e Njesisë Kryesore. Sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit ky program studimi është i nivelit 6 dhe siguron kualifikime e specializime për studentët e infermierisë. Sipas IAL-së, ky program studimi është kodifikuar sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve si dhe kodifikimit të hapësirës evropiane International Standard Classification of Education ISCED.</p> <p>Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore, në Fakultetin e Studimeve Profesionale në të cilin përfshihen edhe programe të tjera studimi (si psh. Navigacion dhe Menaxhim Detar etj) të cilat nuk janë të afërta me fushën akademike e kërkimore të Njesisë Kryesore. GVJ konsideron si të rëndësishme krijimin e një Njësie Kryesore e cila të ketë fokus vetëm Shkencat Mjekësore.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale;</i></p> <p><i>Nr.26 Kodifikimi i Programeve në UAMD;</i></p> <p><i>Nr. 33 Struktura UAMD;</i></p> <p><i>Nr. 33.1 Organigrama e UAMD, Programet UAMD.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme”, është një program studimi i cili ofrohet nga Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore, në Fakultetin e Studimeve Profesionale, në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës. Ky program studimi është në harmoni me interesat kombëtare si dhe misionin dhe objektivat e IAL-së. UAMD ka eksperiencën dhe kapacitete për ofrimin e këtij program studimi. GVB konsideron si të rëndësishme krijimi e një Njësie Kryesore e cila të ketë fokus vetëm Shkencat Mjekësore. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të




realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>UAMD është një Institucion i Arsimit të Lartë dhe ka në përbërjen e vet Njësi Kryesore, Njësi Bazë si dhe struktura ndihmëse. Njësitë dhe strukturat e Institucionit bashkëpunojnë me njëra tjetrën në bazë të statutit dhe rregullores së IAL-së si dhe të Njësive përkatëse. Në varësi të Rektorit të UAMD janë të gjitha Njësitë Akadematike si dhe struktura ndihmës akademike ndërsa në varësi të Administratorit janë ato të financës, shërbimeve dhe investimeve/prokurimeve. Komunikimi zyrtar mes njësive dhe strukturave brenda institucionit bazohet dhe në Rregulloren për qarkullimin dhe arshivimin e dokumentacionit të brendshëm në UAMD. Kjo rregullore përcakton qartë marrëdhëniet dhe komunikimin midis strukturave dhe njësive të UAMD. Në mbledhjet e zhvilluara planifikohen dhe jepen detyrat përkatëse për njësitë/strukturat/personelin. Vendimet, urdhërat dhe udhëzimet e Drejtuesve i shtrijnë efektet e tyre në drejtimit përkatëse, në formë dhe përmbajtje brenda kompetencave ligjore.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 04 Statuti UAMD;</i></p> <p><i>Nr. 08 Rregullore e FSP;</i></p> <p><i>Nr. 09 Rregullore e Departamentite Shkencave Teknike Mjekësore;</i></p> <p><i>Nr. 20 Rregullorja për Qarkullimin dhe Arshivimin e dokumentacionit të brendshëm në UAMD;</i></p> <p><i>Nr.33 Struktura UAMD 2019;</i></p> <p><i>Nr.33.1 Organograma e UAMD, Programet UAMD.</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>UAMD konsideron bashkëpunimin me institucione homologe brenda ose jashtë vendit si të rëndësishëm. Në planin strategjik të vet, IAL, konsideron ndërkombëtarizimin si një nga shtyllat kryesore të zhvillimit të vet. Për këtë arsye, UAMD ka hartuar dhe “Strategjinë e Ndërkombëtarizimit 2019-2021” e cila synon që Universiteti të jetë një aktor i rëndësishëm në zhvillimin social-ekonomik të qytetit dhe rajonit duke i ofruar studentëve dije dhe njohuri akademike cilësore në përputhje me standardet ndërkombëtare për arsimin e lartë. Ndër linjat e veprimit për arritjen e këtij qëllimi është rritja e partneriteteve midis insitucioneve te huaja të Arsimit të Lartë, duke i bërë</p>



	<p>marrëveshjet aktuale të shkëmbimit të studenteve dhe të stafit akademik më domethënëse në formë të tillë që të ofrohen diploma të përbashkëta apo të dyfishta me universitetet partnere në kuadrin e disa programeve të caktuara studimesh me interes të përbashkët, si pasojë brezat e rinj të studentëve do të jenë në gjendje të bashkëpunojnë në një mjedis multikulturor.</p> <p>Plani strategjik i Njesisë Kryesore po ashtu ka si objektiv bashkëpunimin me Institucione brenda dhe jashtë vendit. UAMD ka një numër të lartë bashkëpunimesh me IAL brenda dhe jashtë vendit. Paralelisht, me qëllim zhvillimin e procesit mësimor, ka marrëveshje bashkëpunimi me Spitalin Rajonal Durrës si dhe me qendra e klinika publike e private shëndetësore të cilat janë në kuadër të zhvillimit të praktikave mësimore. Në diskutimin me studentët, ata raportuan se nuk kanë zhvilluar praktika në ndonjë qendër apo spital tjetër përveç atij të Durrësit.</p> <p>GVJ konsideron si të rëndësishme implementimin edhe të marrëveshjeve të tjera të cilat institucioni ka nënshkruar.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 6 Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025;</i></p> <p><i>Nr. 19 Strategji ndërkombetarizimi UAMD 2019-2021;</i></p> <p><i>Nr. 34 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD;</i></p> <p><i>Nr. 94 Lista e Marrëveshjeve të bashkëpunimit DSHTM.</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Në bazë të Statutit të UAMD, Njësia Kryesore përmes autoriteteve të saj ka mundësinë të nënshkruaj marrëveshje kur fusha e veprimit është brenda juridiksionit të fakultetit/departamentit. Me qëllim realizimin e programit mësimor, UAMD ka nënshkruar marrëveshje të posaçme me Spitalin Rajonal Durrës, Qendrën Spitalore “Nënë Tereza”, Tiranë si dhe me qendra e klinika publike e private shëndetësore. Këto marrëveshje i japin mundësinë studentëve të zhvillojnë praktikat profesionale/mësimore ose praktikat klinike të cilat parashikohen në programin e studimit.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 04 Statuti UAMD, neni 27;</i></p> <p><i>Nr. 34 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD;</i></p> <p><i>Nr. 94 Lista e Marrëveshjeve të bashkëpunimit DSHTM.</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia</p>	<p>Në kuadër të legjislacionit në fuqi, Institucioni në fund të vitit kalendarik harton raportin vjetor të vet në bazë të raporteve që</p>

<p>përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Njësitë Bazë dhe Njësitë Kryesore hartojnë. Në këtë raport përfshihet edhe informacion mbi bashkëpunimet e mundshme që Insitucioni ka me IAL vendase e të huaja si dhe me struktura të tjera. Në takimin me drejtuesit e Njësisë ata raportuan se nuk ka raporte të tilla por në përgjithësi marrëveshjet kanë ecur mirë. Nuk u paraqit nga UAMD një raport specifik mbi përfitimet specifike nga marrëveshjet e ndryshme dhe GVJ konsideron si të rëndësishme hartimin e raporteve të tilla në të ardhmen.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.64 Raport Vjetor UAMD 2020-2021;</i></p> <p><i>Takim me Drejtuesen e Njësisë Bazë;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD konsideron bashkëpunimin me institucione homologe brenda ose jashtë vendit si të rëndësishëm. Në planin strategjik të vet, IAL, konsideron ndërkombëtarizimin si një nga shtyllat kryesore të zhvillimit të vet. UAMD ka një numër të lartë bashkëpunimesh me IAL brenda dhe jashtë vendit. Paralelisht, me qëllim zhvillimin e procesit mësimor, ka marrëveshje bashkëpunimi me qendra e klinika publike e private shëndetësore. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<p>Standardi II.1</p> <p>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

M. [Signature]

<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme” është i organizuar në lëndë e module. Ky program zhvillohet në përputhje me rregullat dhe parimet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë. Diplomat ofrohen në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) dhe vlerësimi shprehet sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe Sistemit Amerikan të Krediteve, për të krijuar lehtësi lexueshmërie, transferimi dhe vazhdimi të studimeve universitare në universitetet e tjera brenda dhe jashtë vendit. Programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS. Me qëllim lehtësimin e integritimit të studentëve të diplomuar pranë FSP-së në tregun e punës, ofrohet edhe konvertimi në kredite UsCr (e cila ka lidhje me sistemin Amerikan të krediteve). Veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë: 1) Lëndë bazë; 2) Lëndë karakterizuese; 3) Lëndë ndërdisiplinore; 4) Lëndë plotësuese; dhe 5) Detyrime përmbyllëse. Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është jo më pak se 60 kredite ndërsa në total studentët për tre vitet e studimit mund të grumbullojnë 180 ECTS.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale;</i></p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e programit të studimeve, Neni 10 dhe 11.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Formimi, zhvillimi dhe trasmetimi i dijeve mbetet objektiv kryesor, me qëllim aftësimin e studentëve tanë për transformimin e tyre personal, suksesin profesional dhe përmirësimin e të mirave të përbashkëta, nëpërmjet një mjedisi dinamik, pro angazhimit në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie dhe gjithëpërfshirje në kërkimin shkencor, nëpërmjet ofrimit të hapësirave për më shumë komunikim, diskutim të lirë dhe të gjallë, në respekt të ndërsjellë për formimin me bindje individuale, si akselerues i angazhimit social-komunitar. Ky program studimi ka si qëllim formimin infermieror të studentëve. Ata kanë mundësinë të marrin njohuri teorike e praktike në këtë fushë të veçantë. Kjo u jep atyre mundësinë të japin zgjidhje në probleme komplekse të cilat mund të kenë pacientët e tyre.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 04 Statuti i UAMD;</i></p> <p><i>Nr. 08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale;</i></p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e programit të studimeve.</i></p>

<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese si dhe mënyrën e grupimit të lëndëve/moduleve. Studimet e programit të ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme” zhvillohen në 3 vite akademike. Pika 5 e nenit 10 të Rregullores së programit përcakton se në programin e ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme” çdo lëndë mësimore organizohet si ndërthurje e elementëve të përcaktuar në aktet nënligjore në fuqi. Ato mund të jenë të ndërthurura si më poshtë: a) Në orë leksione; b) Në orë seminare; c) Në orë mësimi të integruara të leksioneve me seminarët; d) Në orë ushtrime; e) Në orë laborator; f) Në projekte/detyra kursi individuale dhe/ose në grup; g) Në provime të ndërmjetme dhe provime përfundimtare; h) Në formën e seancave të praktikës profesionale të zhvilluara në auditor, si një komponent mësimor i veprimtarive formuese që karakterizojnë një program studimi. Ndarja e orëve mësimore sipas elementëve të mësipërme të studimit për çdo lëndë, përcaktohet në kurrikulën (planin mësimor) të programit të studimit të miratuar nga Departamenti Shkencave Teknike Mjekësore, në bazë të krediteve që i janë caktuar disiplinës.</p> <p>Veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë: 1) Lëndë bazë; 2) Lëndë karakterizuese; 3) Lëndë ndërdisiplinore; 4) Lëndë plotësuese; dhe 5) Detyrime përmbyllëse. Sipas programit të studimit, reditet në çdo kategori janë: lëndë bazë (28 kredite), lëndë karakterizuese (99 kredite), Lëndë ndërdisiplinore/integruese (22 kredite), lëndë plotësuese (26 kredite) dhe detyrime përmbyllëse (5 kredite).</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e programit të studimeve;</i></p> <p><i>Nr. 80 Të dhëna tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik në të gjitha programet e studimit të DSHTM v.a. 2019-2020;</i></p> <p><i>Nr. 80.1 Të dhëna tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik në të gjitha programet e studimit të DSHTM v.a. 2020-2021;</i></p> <p><i>Nr. 80.2 Të dhëna tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik në të gjitha programet e studimit të DSHTM v.a. 2021-2022;</i></p> <p><i>Nr. 132 Kurrikula e programit të studimit Bachelor në „Infermieri e përgjithshme“.</i></p>
--	--




<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Praktika Profesionale është pjesë e programit mësimor (kurrikulave) të programit të ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme“ të Departamentit të Shkencave Teknike Mjekësore.</p> <p>Studenti në bazë të kurrikulës përkatëse duhet të kryejë Praktikën Profesionale, si një nga kategoritë e veprimtarive formuese, si edhe të vlerësohet për të. Studenti vlerësohet për Praktikën Profesionale pas përfundimit të saj me sistemin e pikëve (1000 pikë totali), i cili konvertohet në sistemin e notave, nga nota minimale 4 (katër) deri në notën maksimale 10 (dhjetë). Nota kaluese më e ulët është nota 5 (pesë) e cila korrespondon me 51% të pikëve të fituara.</p> <p>Praktika profesionale, e cila zhvillohet në kuadër të këtij program studimi, ka në total 7 (shtatë) kredite. Neni 72 i rregullores së Departamentit si dhe neni 41 i Rregullores së programit të studimeve përcaktojnë qartë detyrimet përmbyllëse të studentëve për këtë program studimi. Rregullore specifike për mikrotezën dhe detyrimet përfundimtare janë miratuar dhe janë në dijeni të studentëve.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 09 Rregullore e Departamentit;</i></p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e programit të studimeve;</i></p> <p><i>Nr. 80.2 Të dhena tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik në të gjitha programet e studimit të DSHTM v.a. 2021-2022;</i></p> <p><i>Nr.97 Rregullore e Mikrotezës në Fakulteti i Studimeve Profesionale;</i></p> <p><i>Nr.97.1 Rregullore e mikrotezës dhe provimit final DSHTM;</i></p> <p><i>Nr. 132 Kurrikula e programit të studimit Bachelor në „Infermieri e Përgjithshme“.</i></p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimit të studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të</p>	<p>Organizimi i studimeve është me kohë të plotë dhe për t'u pranuar në këtë program studimi, studentit duhet të zotërojë një diplomë të shkollës së mesme vendase apo të huaj me kohëzgjatje tre vjet, ose sipas sistemit të vjetër me kohëzgjatje katër vjet, ose dhe shkollë të mesme profesionale me kohëzgjatje pesë vjet. Neni 9 i Rregullores së programit të studimeve përcakton pranimet në këtë program studimi. Organizimi i studimeve si dhe pranimit të studentëve është në përputhje me Ligjin 80/2015 si dhe me aktet ligjore e nënligjore si dhe udhëzimet e MAS.</p>

<p>ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Evidenca: <i>Nr. 10 Rregullore e programit të studimeve.</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit ka ngjashmëri me programe të tjera të cilat kanë emërtim të njëjtë/ngjashëm dhe që ofrohen në IAL publike/private, vendase edhe/ose të huaja. Në diskutimet e zhvilluara me Drejtuesit e IAL-së si dhe stafin akademik, ata raportuan se mundohen të përshtasin programin e studimeve me qëllim ngjashmëri sa më të lartë. Paralelisht, ata referuan se studentët që diplomohen në këtë program studimi, janë të detyruar të japin provim në rang kombëtar për të marrë licënsimin gjë që tregon dhe ngjashmërinë e këtij program studimi.</p> <p>Evidenca: <i>Nr. 10 Rregullore e programit të studimeve;</i> <i>Nr. 80 Të dhëna tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik në të gjitha programet e studimit të DSHTM v.a. 2019-2020;</i> <i>Nr. 80.1 Të dhëna tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik në të gjitha programet e studimit të DSHTM v.a. 2020-2021;</i> <i>Nr. 80.2 Të dhëna tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik në të gjitha programet e studimit të DSHTM v.a. 2021-2022.</i></p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Kodifikimi i programit është në proces dhe nuk është përfunduar akoma. Në përfundim të kodifikimit të programeve të studimit në rang kombëtar, do të kodifikohen respektivisht dhe lëndët/modulet në këtë program studimi. Në takimin me Drejtuesen e Njësisë Bazë ajo përmendi si jemi në proces dhe nuk është përfunduar akoma. Ky proces nuk është përfunduar pasi pritet realizimi i tij nga MAS, bazuar edhe në udhëzimin e publikuar.</p> <p>Evidenca: <i>Nr. 26 Kodifikimi i Programeve ne UAMD;</i> <i>Takim me Drejtuesen e Njësisë Bazë.</i></p>
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj,</p>	<p>Ky nuk është një program i përbashkët.</p>




në përputhje me legjislacionin në fuqi.									
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme" është i organizuar në lëndë e module. Ky program zhvillohet në përputhje me rregullat dhe parimet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë. Formimi, zhvillimi dhe trasmetimi i dijeve mbetet objektiv kryesor, me qëllim aftësimin e studentëve. Studimet e programit të ciklit të parë të studimeve Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme" zhvillohen në 3 vite akademike. Në secilin vit akademik studentët mund të përfitojnë deri më 60 ECTS (180 në total). Organizimi i studimeve është me kohë të plotë dhe për t'u pranuar në këtë program studimi, studenti ka detyrime specifike. Kodifikimi i programit është në proces dhe nuk është përfunduar akoma. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Njësia Kryesore, Fakulteti i Studimeve Profesionale, e cila ofron këtë program studimi plotëson detyrimet ligjore. Ajo ka në përbërjen e saj:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe të Natyrës; 2. Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore; 3. Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë; 4. Departamenti i Studimeve të Integruara me Praktikën; <p>Departamenti në përputhje me numrin e personelit akademik, fushat kërkimore shkencore, disiplinat, profilet, ciklet e studimit ka grupet mësimore e kërkimore të cilat kanë detyra specifike (neni 18 i Rregullores së Fakultetit).</p> <p>Në total ka 3 (tre) grupe Mësimore-Kërkimore Shkencore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Grupi Mësimor-Kërkimor Shkencor Paraklinik; 2. Grupi Mësimor-Kërkimor Shkencor Klinik; 3. Grupi Mësimor-Kërkimor Shkencor Infermieror. <p>Secila Njësi Bazë ka të paktën 7 (shtatë) staf akademik (3 (tre) nga të cilët me gradë shkencore/titull akademik). Në vitin</p>

akademik 2022 – 2023, njësia bazë përbëhet nga **18 anëtarë PAE** dhe përfshin në mësimdhënie dhe **30 anëtarë PAK**. Kualifikimi i personelit akademik të përfshirë në mësimdhënie nga viti 2019 është:

Në tabelat shoqëruese të RVB si dhe CV e personelit akademik jepet një informacion i detajuar mbi numrin dhe cilësitë e personelit akademik të përfshirë në programin e studimit Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme”.

Viti akademik	PAE		PAK	
	Nr.	Titulli/Grada	Nr.	Titulli/Grada
2019-2020	1	Prof.Dr.		
	11	Dr.	5	Dr.
	2	(PhD/Dr. në proçes)		
	2	Msc.	12	Msc.
	2	Msc.Spa	12	Msc.Spa
2020-2021	1	Prof.Dr.		
	11	Dr.	6	Dr.
	2	(PhD/Dr. në proçes)	2	(Dr. në proçes)
	2	Msc.	6	Msc.
	2	Msc.Spa	9	Msc.Spa
2021-2022	1	Prof.Dr.		
	2	Prof.As.		
	11	Dr.	6	Dr.
	1	(Dr. në proçes)	2	(Dr. në proces)
	1	Msc.	10	Msc.
	2	Msc.Spa.	7	Msc.Spa.

	<div style="border: 1px solid black; width: 100%; height: 40px; margin-bottom: 10px;"></div> <p>Evidenca: <i>Nr. 08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale;</i> <i>Nr. 09 Rregullore e Departamentit;</i> <i>Nr. 10 Rregullore e programit të studimeve;</i> Nr. 56 Organigrama e FSP; <i>Nr. 80 Të dhëna tabelare për personelin akademik të DSHTM (ngarkesa e stafit, cilësia e stafit, kërkimi shkencor i stafit).</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Njësia Kryesore dhe Bazë të cilat janë përgjegjëse për ofrimin e këtij program studimi përbushin detyrimet ligjore duke përfshirë edhe personel ndihmës akademik/administrative. Ky Program studimi ka 2 (dy) laborantë ndërsa departamentit kishte 1 (një) sekretare e cila ishte përgjegjëse për programin e studimit.</p> <p>Evidenca: <i>Tabela 2: Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit -stafi ndihmës;</i> <i>Tabela 8 _ Personeli - të dhëna + kualifikim.</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Neni 18 i Rregullores së Departamentit përcakton rolin dhe detyrimet e koordinatorit të programit të studimit.</p> <p>Studentët nuk kishin njohuri mbi koordinatorin e programit të studimit.</p> <p>Evidenca: <i>Nr. 09 Rregullore e Departamentit;</i> Takimi me studentët.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Njësia Kryesore e cila ofron këtë program studimi plotëson detyrimet ligjore. Departamenti në përputhje me numrin e personelit akademik, fushat kërkimore shkencore, disiplinat, profilet, ciklet e studimit ka grupet mësimore. Ky program studimi përbushin detyrimet ligjore duke përfshirë edhe personel ndihmës akademik/administrativ. Njësia Bazë ka një</i></p>




	<i>koordinator për këtë program studimi. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3


Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Sipas Rregullores së Njesisë Kryesore, programet e studimeve të ciklit të parë synojnë të japin njohuri bazë mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi të caktuara në një larmi të gjerë profesioneve e specialitetesh. Ato organizohen në jo më pak se 180 kredite evropiane për një periudhë të paktën 3 (tre) vite. Detaje mbi organizimin e studimeve (forma e studimit, modulet/programet, gjuha, transferimi etj.) jepen në Rregulloren e Departamentit (Nenet 36-48). Më shumë detaje mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme” prezantohen në rregulloren e programit të studimeve (nenet 9-14). Paralelisht, gjatë takimit në UAMD drejtuesja e Departamentit konfirmoi se ky informacion është i disponueshëm.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale (neni 31);</i></p> <p><i>Nr. 09 Rregullore e Departamentit;</i></p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e programit të studimeve;</i></p> <p><i>Takimi me Drejtuesen e Departamentit</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Plani mësimor është pasqyra e lëndëve të ofruara nga një program studimi ku përcaktohen lëndët e programit të studimit, të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, dhe shpërndarja e tyre përgjatë kohëzgjatjes normale të programit të studimit në vite e semestra. Ajo hartohet nga Departamenti i Shkencave Mjekësore Teknike, miratohet nga Dekanati i Fakultetit të Studimeve Profesionale dhe në përfundim dërgohet për miratim në Senatin Akademik. Neni 11 i Rregullores së programit të studimeve prezanton pikat kryesore të planit mësimor. Sipas nenit 10, pika 3, viti akademik ndahet në semestral ndërsa pika 5 detajon se çdo</p>

	<p>lëndë mësimore organizohet si ndërthurje e elementëve të përcaktuar në aktet nënligjore në fuqi. Ato mund të jenë të ndërthurura si më poshtë: a) Në orë leksione; b) Në orë seminare; c) Në orë mësimi të integruara të leksioneve me seminarët; d) Në orë ushtrime; e) Në orë laborator; f) Në projekte/detyra kursi individuale dhe/ose në grup; g) Në provime të ndërmjetme dhe provime përfundimtare; h) Në formën e seancave të praktikës profesionale të zhvilluara në auditor, si një komponent mësimor i veprimtarive formuese që karakterizojnë një program studimi; i) private të zgjedhura nga vetë studenti e të dakortësuara me pedagogun përkates të praktikës; j) Apo çdo formë tjetër të miratuar nga Fakulteti i Studimeve Profesionale.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e programit të studimeve;</i></p> <p><i>Nr.132 Kurrikula e programit të studimit Infermieri e pergjithshme.pdf;</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Për t'u pranuar në këtë program studimi, studenti duhet të zotërojë një diplomë të shkollës së mesme vendase apo të huaj me kohëzgjatje tre vjet, ose sipas sistemit të vjetër me kohëzgjatje katër vjet, ose dhe shkollë të mesme profesionale me kohëzgjatje pesë vjet. Kandidati mund të ketë edhe ndonjë diplomë tjetër studimi të ndjekur në një institucion jashtë vendit që njihet dhe është e vlefshme, në përputhje me legjislacionin ekzistues. Proçesi i vlerësimit të diplomës bëhet nga UAMD. Detaje mbi pranimin në këtë program studimi prezantohen në Nenin 9 të Rregullores së Programit të studimeve ndërsa neni 29 jep informacione mbi transferimin e studimeve, njohjen dhe njehsimin e diplomave. Informacion më i detajuar mbi kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit jepet dhe tek kërkesa e Njësisë Bazë e cila miratohet nga Senati Akademik dhe i përcillet MAS.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e programit të studimeve;</i></p> <p><i>Nr.90 Urdhër për ngritjen e komisionit të transferimit;</i></p> <p><i>Nr.110 Kriteret e pranimit të studentëve dhe kuotat</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën</p>	<p>Sipas nenit 12 të Rregullores së programit të studimeve, syllabusi është programi i lëndës në të cilin parashikohen objektivat e lëndës, literatura e detyrueshme e miratuar në Departament, literatura e sugjeruar për informacion shtesë, temat, orët për leksionet, seminarët, ushtrimet, laboratorët,</p>




<p>lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>seancat e praktikave profesionale, kohëzgjatjen e lëndës, rregullat e provimit dhe të mënyrave të vlerësimit. Syllabusi hartohet nga lektori përgjegjës jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë përpara fillimit të semestrit dhe miratohet tek Përgjegjësi i Departamentit përkatës. Përgjegjësi i Departamentit merr miratimin e Grupit mësimor, kërkimor-shkencor për syllabuset të cilat mbulohen nga ky grup. Përgjegjësi i Departamentit për çdo lëndë që mbulon duhet të ketë dosjen me materialet që përfshijnë kopjet e syllabusit për çdo semestër si dhe materialet mësimore të lëndës të përcaktuara në rregulloren e njësisë kryesore. Në takimin më drejtuesen e departamentit dhe stafin akademik ata raportuan se një kopje e syllabusit dorëzohet në fillim të tetorit (miratohet paraprakisht nëse ka ndryshime) dhe dorëzohet një në departament dhe një pranë Sektorit të Kurrikulave.</p> <p>Formati i syllabuseve nuk ka element si objektivat, rezultatet e pritshme (njohuritë, aftësitë dhe kompetencat) që studentët përfitojnë ndërsa literatura në një pjesë të tyre është e vjetër dhe duhet përditësuar. Përdorimi i formatit të fundit të propozuar nga MAS është i nevojshëm të përdoret.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e programit të studimeve;</i></p> <p><i>Takimi me Drejtuesen e Departamentit;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik;</i></p> <p><i>Nr.124.1 Syllabuset Bachelor në „Infermieri e Përgjithshme“ v.a. 2021-2022.</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Programi i studimit përmirësohet rregullisht siç parashikohet në Rregulloren e programit të studimeve si dhe siç u raportua gjatë takimeve në UAMD. Syllabuset përditësohen duke ndjekur procedurën e lartpërmendur.</p> <p>Nuk u prezantua ndonjë procedurë specifike ku Njësia Bazë ka përditësuar këtë program studimi. Është e nevojshme dokumentimi i përditësimit të programit të studimit sa herë që ai bëhet.</p> <p>Evidenca:</p>
	<p><i>Nr. 10 Rregullore e programit të studimeve;</i></p> <p><i>Takimi me Drejtuesen e Departamentit;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik;</i></p>




	<p><i>Nr.123 Syllabuset Bachelor në „Infermieri e Përgjithshme“ v.a. 2019-2020;</i></p> <p><i>Nr.124. Syllabuset Bachelor në „Infermieri e Përgjithshme“ v.a. 2020-2021;</i></p> <p><i>Nr.124.1 Syllabuset Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme” v.a. 2021-2022.</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Detaje mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme” prezantohen në rregulloren e programit të studimeve (nenet 9-14). Plani mësimor është pasqyra e lëndëve të ofruara ndërsa detaje mbi pranimin në këtë program studimi prezantohen në Nenin 9 të Rregullores së Programit të studimeve syllabusi është programi i lëndës në të cilin parashikohen objektivat e lëndës, literatura e detyrueshme e miratuar në Departament, literatura e sugjeruar për informacion shtesë etj. Nuk u prezantua ndonjë procedurë specifike ku Njësia Bazë ka përditësuar këtë program studimi. GVJ mendon se ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme” ju ofron studentëve mundësinë të thellojnë njohuritë e tyre në fushën e infermierisë si dhe mundësi të mëtejshme për punësim. Gjatë takimit në UAMD, u raportua si nga stafi akademik por edhe nga studentët se një pjesë e tyre vazhdojnë studime (ose dëshirojnë të vazhdojnë) në këtë Universitet.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e programit të studimeve;</i></p> <p><i>Takimi me Drejtuesen e Departamentit;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik;</i></p> <p><i>Takim me studentët;</i></p>

	<i>Tabela 23 - Punesimi i studenteve.</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	<p>Ka një ndërthurje të lëndëve të përgjithshme me lëndët më specifike. Ato janë të shpërndara në vite e semestra dhe mundësojnë formimin profesional dhe shkencor të studentëve. Plani mësimor mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit. Plani mësimor është i ndarë në lëndë/module me kredite specifike (180 kredite në total). Në syllabuset e lëndëve përcaktohen kreditet dhe orët brenda dhe jashtë auditorit (leksione, seminare, laborator, praktik profesionale etj.), ndërsa objektivat e përgjithshme dhe specifike si dhe rezultatet e pritshme të të nxënit nuk janë të pasqyruara qartë.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.121 Dosja e programit te studimit (kurrikula, plani mësimor, dhe personeli akademik);</i></p> <p><i>Nr.124.1 Syllabuset Infermieri e përgjithshme v.a. 2021-2022;</i></p> <p><i>Tabela 9_Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E);</i></p> <p><i>Tabela 10 Planet me ndarje.</i></p>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	<p>Programi i studimit përfshin orë brenda dhe jashtë auditorit. Në total ky program për tre vite akademike kërkon angazhimin për 4500 orë (2050 brenda në auditor dhe 2450 jashtë). Programi përfshin teori dhe praktikë. Syllabuset e lëndëve pasqyrojnë qartë orët teorike dhe praktike që duhet të ndjekin studentët. Në diskutimet në UAMD, u raportua se ky program është i ngjashëm me programe të tjera brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.121 Dosja e programit te studimit (kurrikula, plani mësimor, dhe personeli akademik);</i></p> <p><i>Nr.124.1 Syllabuset Infermieri e përgjithshme v.a. 2021-2022;</i></p> <p><i>Tabela 9_Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E);</i></p> <p><i>Tabela 10 Planet me ndarje;</i></p>
	<p><i>Takimi me Drejtuesen e Departamentit;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik.</i></p>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit	<p>Plani mësimor është i ndarë në lëndë bazë (28 kredite), lëndë karakterizuese (99 kredite), Lëndë ndërdisiplinore/ integruese (22 kredite), lëndë plotësuese (26 kredite) dhe detyrime</p>

<p>teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>përmbyllëse (5 kredite). Mënyra e ndarjes u jep mundësinë studentëve jo vetëm të arrijnë objektivat formuese të tyre por edhe të transferojnë studimet e tyre si dhe të punësohen.</p> <p>Në takimin me studentët u raportua që asnjë nga ata nuk kishte zhvilluar transferim të studimeve ose mobilitet afatshkurtër. Kjo është një fushë ku më shumë përpjekje janë të nevojshme për tu bërë.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.121 Dosja e programit të studimit (kurrikula, plani mesimor, dhe personeli akademik);</i></p> <p><i>Tabela 9 Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E).</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Syllabusi hartohet nga lektori përgjegjës jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë përpara fillimit të semestrit dhe miratohet tek Përgjegjësi i Departamentit përkatës. Përgjegjësi i Departamentit merr miratimin e Grupit mësimor, kërkimor-shkencor për syllabuset të cilat mbulohen nga ky grup. Përgjegjësi i Departamentit për çdo lëndë që mbulon duhet të ketë dosjen me materialet që përfshijnë kopjet e syllabusit për çdo semestër si dhe materialet mësimore të lëndës të përcaktuara në rregulloren e njësisë kryesore.</p> <p>Në takimin më drejtuesen e departamentit dhe stafin akademik ata raportuan se një kopje e syllabusit dorëzohet në fillim të tetorit (miratohet paraprakisht nëse ka ndryshime) dhe dorëzohet një në departament dhe një pranë Sektorit të Kurrikulave. Syllabuset përditësohen rregullisht u raportua në takimet e zhvilluara në UAMD. Pedagogët raportuan se syllabusi përditësohet çdo vit në bazë të nevojave.</p> <p>GVJ nuk pa ndryshime thelbësore në syllabuse në tre vitet e fundit sipas dokumentacionit të dorëzuar nga UAMD. Përditesimi i rregullt i syllabuseve është i nevojshëm si dhe dokumentimi i ndryshimeve të bëra.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e programit të studimeve;</i></p> <p><i>Takimi me Drejtuesen e Departamentit;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik;</i></p> <p><i>Nr.123 Syllabuset Infermieri e pergjithshme v.a. 2019-2020;</i></p> <p><i>Nr.124. Syllabuset Infermieri e pergjithshme v.a. 2020-2021;</i></p> <p><i>Nr.124.1 Syllabuset Infermieri e pergjithshme v.a. 2021-2022.</i></p>




<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimën e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme” përfshin element si leksione, seminare, laboratore, praktika profesionale etj. Kjo ndërthurje e këtyre elementëve u jep mundësinë studentëve të fitojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të reja.</p> <p>GVJ konsideron se këto duhet të pasqyrohen më qartë në syllabuset e pedagogëve të cilat kanë nevojë për përditësim si dhe për rishikim të literaturës së përdorur.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e programit të studimeve;</i></p> <p><i>Nr.123 Syllabuset Infermieri e pergjithshme v.a. 2019-2020;</i></p> <p><i>Nr.124. Syllabuset Infermieri e pergjithshme v.a. 2020-2021;</i></p> <p><i>Nr.124.1 Syllabuset Infermieri e pergjithshme v.a. 2021-2022.</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Në përfundim të këtij cikli studimesh, studentët kanë mundësi të vazhdojnë studimet e tyre rreth ose jashtë vendit por edhe të punësohen. Gjatë takimeve në UAMD u raportua se përqindja e studentëve të cilët marrin provimin e licensës është i lartë ndërsa një pjesë e madhe e të diplomuarve punësohen jo vetëm në Shqipëri, gjë që tregon përshtatjen e programit me tregun e punës.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Takimi me Drejtuesen e Departamentit;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik;</i></p> <p><i>Takim me studentët;</i></p> <p><i>Tabela 23 - Punësimi i studenteve;</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme” ju ofron studentëve mundësinë të thellojnë njohuritë e tyre në fushën e infermierisë si dhe mundësi të mëtejshme për punësim. Programi i studimit përfshin orë brenda dhe jashtë auditorit dhe element si leksione, seminare, laboratore, praktika profesionale etj. GVJ nuk pa ndryshime thelbësore në syllabuse në tre vitet e fundit sipas dokumentacionit të dorëzuar nga UAMD. Përditësimi i rregullt i syllabuseve është i nevojshëm si dhe dokumentimi i ndryshimeve të bëra. Në takimin me studentët u raportua që asnjë nga ata nuk kishte zhvilluar transferim të studimeve ose mobilitet afatshkurtër. GVJ mendon se ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

			X	
--	--	--	---	--

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Programi i studimit përmirësohet në bazë të sugjerimeve të stafit akademik dhe të studentëve të cilët shprehin mendimet e tyre përmes pyetësorit të zhvilluar. Nuk u raportua ndonjë praktik specifike për përmirësimin e këtij program studimi ku të kenë marrë pjesë aktorë të jashtëm apo institucione partnere të UAMD. Kjo është një pikë e dobët për të cilën Institucioni duhet të punoj më shumë. Përfshirja e aktorëve të jashtëm do i japi mundësi UAMD të përshtasi programin e studimit në bazë të nevojave të tregut të punës. Mos përfshirja e aktorëve të jashtëm u raportua dhe nga Drejtuesia e Departamentit gjatë takimit në Institucion.</p> <p>Evidenca: <i>Nr.106 Formular tip vleresim stafi nga studentet;</i> <i>Takimi me Drejtuesen e Departamentit;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Studentët përfshihen në përmirësimin e programit të studimit përmes pyetësorit të cilit ata plotësojnë. Në përfundim të pyetësorit NJSBC harton raportin dhe ia përcjell organeve repektive. Studentët të cilët morën pjesë në takim raportuan se nuk kishin marrë pjesë në ndonjë procedurë për përmirësimin e programit të studimit. Paralelisht, sektori i Karrierës, Alumni dhe Komunikimit raportoi se zhvillon gjurmim të rregullt me të diplomuarit. Kontakti i vazhdueshëm me alumni për përmirësimin e programit të studimit është i nevojshëm dhe UAMD duhet të punoj më shumë në këtë drejtim.</p> <p>Evidenca: <i>Nr.24 Raporti i sigurimit te cilesise UAMD;</i> <i>Nr.106 Formular tip vleresim stafi nga studentet;</i> <i>Takimi me studentët;</i> <i>Takim me përfaqshues të Sektorit të Karrierës, Alumni dhe Komunikimit.</i></p>

<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Gjatë takimeve në UAMD u raportua se programi përmirësohet rregullisht në bazë të nevojave dhe të zhvillimeve shkencore. U raportua se kanë kontakte të rregullta me urdhërin e infermierit.</p> <p>GVJ-së nuk ju vu në dispozicion ndonjë procedurë specifike e përmirësimit dhe përditësimit të programit të studimeve në bashkëpunim me rrjete profesionistësh dhe urdhërin e infermierit. GVJ konsideron si të rëndësishme përmirësimin e programit duke përfshirë këto grupe interesi si dhe duke i dokumentuar këto aktivitete/takime.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Takimi me Drejtuesen e Departamentit;</i></p> <p><i>Takimi me stafin akademik.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit përmirësohet në bazë të sugjerimeve të stafit akademik dhe të studentëve të cilët shprehin mendimet e tyre përmes pyetësorit të zhvilluar. Nuk u raportua ndonjë praktik specifike për përmirësimin e këtij program studimi ku të kenë marrë pjesë aktorë të jashtëm apo institucione partnere të UAMD. GVJ konsideron si të rëndësishme përmirësimin e programit duke përfshirë grupet e interesit si dhe duke i dokumentuar këto aktivitete/takime. GVJ mendon se ky standard përmbushet pjesërisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X		

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.





Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Rregullorja e Njesisë Kryesore (neni 42) dhe rregullorja e Njesisë Bazë (neni 49) përcaktojnë qartë format e mësimdhënies. Sipas Rregullores së Programit të studimeve (neni 10), në programin e ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në “Infermieri e Përgjithshme” çdo lëndë mësimore organizohet si ndërthurje e elementëve të përcaktuar në aktet nënligjore në fuqi. Ato mund të jenë të ndërthurura si më poshtë: a) Në orë leksione; b) Në orë seminare; c) Në orë mësimi të integruara të leksioneve me seminarët; d) Në orë ushtrime; e) Në orë laborator; f) Në projekte/detyra kursi individuale dhe/ose në grup; g) Në provime të ndërmjetme dhe provime përfundimtare; h) Në formën e seancave të praktikës profesionale të zhvilluara në auditor, si një komponent mësimor i veprimtarive formuese që karakterizojnë një program studimi; i) private të zgjedhura nga vetë studenti e të dakortësuara me pedagogun përkates të praktikës; j) Apo çdo formë tjetër të miratuar nga Fakulteti i Studimeve Profesionale. Ndarja e tyre bëhet në planin mësimor. Syllabusët e dorëzuara nga pedagogët përfshin të gjitha këto forma me qëllim mësimdhënien dhe mësimnxënien. Përdorimi i këtyre formave u konfirmua dhe nga stafi akademik e studentët gjatë takimeve në UAMD.</p> <table border="1" data-bbox="612 1191 1375 1859"> <thead> <tr> <th data-bbox="612 1191 884 1330">Bsc “Infermieri e Përgjithshme”</th> <th data-bbox="884 1191 979 1330">Viti I</th> <th data-bbox="979 1191 1075 1330">Viti II</th> <th data-bbox="1075 1191 1171 1330">Viti III</th> <th data-bbox="1171 1191 1283 1330">Në total</th> <th data-bbox="1283 1191 1375 1330">Në total %</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="612 1330 884 1384">Në auditor</td> <td data-bbox="884 1330 979 1384">695</td> <td data-bbox="979 1330 1075 1384">705</td> <td data-bbox="1075 1330 1171 1384">650</td> <td data-bbox="1171 1330 1283 1384">2050</td> <td data-bbox="1283 1330 1375 1384">45.6</td> </tr> <tr> <td data-bbox="612 1384 884 1438">Leksione</td> <td data-bbox="884 1384 979 1438">375</td> <td data-bbox="979 1384 1075 1438">370</td> <td data-bbox="1075 1384 1171 1438">310</td> <td data-bbox="1171 1384 1283 1438">1055</td> <td data-bbox="1283 1384 1375 1438">23.5</td> </tr> <tr> <td data-bbox="612 1438 884 1491">Seminare</td> <td data-bbox="884 1438 979 1491">155</td> <td data-bbox="979 1438 1075 1491">165</td> <td data-bbox="1075 1438 1171 1491">165</td> <td data-bbox="1171 1438 1283 1491">485</td> <td data-bbox="1283 1438 1375 1491">10.8</td> </tr> <tr> <td data-bbox="612 1491 884 1545">Laboratore</td> <td data-bbox="884 1491 979 1545">70</td> <td data-bbox="979 1491 1075 1545">0</td> <td data-bbox="1075 1491 1171 1545">0</td> <td data-bbox="1171 1491 1283 1545">70</td> <td data-bbox="1283 1491 1375 1545">1.3</td> </tr> <tr> <td data-bbox="612 1545 884 1697">Praktika profesionale dhe lëndore</td> <td data-bbox="884 1545 979 1697">95</td> <td data-bbox="979 1545 1075 1697">170</td> <td data-bbox="1075 1545 1171 1697">175</td> <td data-bbox="1171 1545 1283 1697">440</td> <td data-bbox="1283 1545 1375 1697">10.0</td> </tr> <tr> <td data-bbox="612 1697 884 1796">Punë e pavarur e studentit</td> <td data-bbox="884 1697 979 1796">805</td> <td data-bbox="979 1697 1075 1796">795</td> <td data-bbox="1075 1697 1171 1796">850</td> <td data-bbox="1171 1697 1283 1796">2450</td> <td data-bbox="1283 1697 1375 1796">54.4</td> </tr> <tr> <td data-bbox="612 1796 884 1859">Gjithsej</td> <td data-bbox="884 1796 979 1859">1500</td> <td data-bbox="979 1796 1075 1859">1500</td> <td data-bbox="1075 1796 1171 1859">1500</td> <td data-bbox="1171 1796 1283 1859">4500</td> <td data-bbox="1283 1796 1375 1859">100</td> </tr> </tbody> </table> <p data-bbox="612 1917 746 1951">Evidenca:</p>	Bsc “Infermieri e Përgjithshme”	Viti I	Viti II	Viti III	Në total	Në total %	Në auditor	695	705	650	2050	45.6	Leksione	375	370	310	1055	23.5	Seminare	155	165	165	485	10.8	Laboratore	70	0	0	70	1.3	Praktika profesionale dhe lëndore	95	170	175	440	10.0	Punë e pavarur e studentit	805	795	850	2450	54.4	Gjithsej	1500	1500	1500	4500	100
Bsc “Infermieri e Përgjithshme”	Viti I	Viti II	Viti III	Në total	Në total %																																												
Në auditor	695	705	650	2050	45.6																																												
Leksione	375	370	310	1055	23.5																																												
Seminare	155	165	165	485	10.8																																												
Laboratore	70	0	0	70	1.3																																												
Praktika profesionale dhe lëndore	95	170	175	440	10.0																																												
Punë e pavarur e studentit	805	795	850	2450	54.4																																												
Gjithsej	1500	1500	1500	4500	100																																												




	<p><i>Nr. 08 Rregullore e Njësisë Kryesore;</i></p> <p><i>Nr. 09 Rregullore e Njësisë Bazë;</i></p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e programit të studimeve;</i></p> <p><i>Nr.123 Syllabuset Infermieri e pergjithshme v.a. 2019-2020;</i></p> <p><i>Nr.124. Syllabuset Infermieri e pergjithshme v.a. 2020-2021;</i></p> <p><i>Nr.124.1 Syllabuset Infermieri e pergjithshme v.a. 2021-2022;</i></p> <p><i>Takimi me stafin akademik;</i></p> <p><i>Takimi me studentët;</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>UAMD ka hartuar një udhëzues për stafin akademik me titull “Aftësim për mësimdhënie ndërvepruese”. Synimi i këtij manuali është: rritja e cilësisë së mësimdhënies në auditorët e arsimit të lartë në UAMD dhe në institucione të tjera të ngjashme në Shqipëri. Ky manual përfshin njohuri në fusha të ndryshme si ndërveprimi, etika pedagogjike, psikologjia etj. Kjo është një praktikë e mirë dhe Institucioni duhet të rrisë përpjekjet që i gjithë stafi akademik të jetë në dijeni të këtij udhëzuesi. Paralelisht, UAMD duhet të përditësoj rregullisht këtë material me qëllim përshtatjen e tij me nevojat e stafit akademik dhe studentëve. Stafi akademik gjatë takimit raportoi se përdor mjete teknologjike e bashkëkohore gjatë leksioneve me qëllim mësimdhënie më interaktive. Përdorimi i metodave interaktive u raportua dhe nga studentët gjatë takimit me ta.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.43 Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik;</i></p> <p><i>Takim me studentët;</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>UAMD mbështet stafin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike përmesa formave të ndryshme. Përveç udhëzuesit për stafin akademik me titull “Aftësim për mësimdhënie ndërvepruese”, UAMD ka nënshkruar marrveshje bashkëpunimi ndërinstytucionale me Universitete të ndryshme Evropiane. Stafi akademik ka mundësinë të zhvilloj mobilitete për mësimdhënie ose trajnim në këto institucione. Stafi akademik konfirmoi se ka marrë pjesë në</p>




	<p>mobilitete të tilla vitet e kaluara. Pjesmarrja në projekte të ndryshme është një formë tjetër të cilën UAMD përdor për të përmirësuar aftësitë mësimdhënëse të stafit akademik. Qendra e Edukimit në Vazhdim që është ngritur pranë UAMD është një tjetër mundësi për përmirësimin e aftësive mësimdhënëse të stafit akademik. Institucioni po ashtu inkurajon stafin akademik të marrë pjesë në aktivitete trajnuese dhe i publikon ato në faqen e vet zyrtare si dhe në rrjetet sociale.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.43 Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve;</i></p> <p><i>Nr.36 Mobiliteti stafit+studente UAMD;</i></p> <p><i>Nr.37 Thirrje për Trajnime dhe Pjesëmarrje në Projekte;</i></p> <p><i>Nr.45 Politika të zhvillimit të stafit akademik;</i></p> <p><i>Nr.94 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të DSHTM;</i></p> <p><i>Nr.96 Tabela me Marrëveshjet e Bashkëpunimit të FSP;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Një nga objektivat kryesore të Planit strategjik të Fakultetit të Studimeve Profesional është ai i Krijimit të Stafit akademik cilësor, të përkushtuar, profesionist dhe etik. Nëpërmjet kërkimit shkencor në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies brenda fushave të ekspertizës dhe investimit paraprak të çdo anëtari të stafit akademik. Personeli akademik i cili është i angazhuar në mësimdhënie ka njohuritë dhe aftësitë e duhura. Rekrutimi i tyre zhvillohet në bazë të disa kriterëve specifik (përfshirë këtu edhe eksperiencën e mëparshme në mësimdhënie dhe kërkim shkencor). Stafi akademik konfirmoi se përdor metoda interaktive gjatë mësimdhënies dhe se qëllimi i tyre është mësimdhënia me në qendër studentin. Studentët konfirmuan këtë më lart. Paralelisht, studentët përmes pyetësorit të përdorur për vlerësimin e mësimdhënies kanë mundësi të shprehin lirshëm mendimet dhe idetë e tyre. Respektimi i kodit të etikës është një nga detyrimet kryesore si të stafit akademik ashtu edhe të studentëve.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program është i kategorisë profesor, doktor dhe master shkencor.</p>




Tituj/ grada	2022-2023		2021-2022		2020-2021	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	0	0	1	0	1	0
Prof.Asc.	3	0	2	0	0	0
Dr./PhD.	11	9	10	6	11	6
Msc.	3	20	3	17	4	15
Totali	16	29	16	23	16	21
* Doktoraturë në proces						

Evidenca:

Nr. 29 Kodi i Etikës i UAMD;

Evidenca Nr.37 Thirrje për Trajnime dhe Pjesëmarrje në Projekte;

Nr. 57 Plani i Zhvillimit Strategjik të Departamentit të Shkencave Teknike Mjeksore;

Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.

Studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme” janë të përfshirë në mënyrë aktive në vlerësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies. Studentët përmes pyetësorit të cilit plotësojnë në fund të semestrit akademik vlerësojnë pedagogët e lëndës respektive. Pyetësori i përdorur përmban pyetje mbi metodat e mësimdhënies, interaktivitetin e pedagogut etj. Bazuar në rezultatet e pyetësorit, NJSBC përpunon të dhënat dhe harton raporte. Këto rezultate janë transparente dhe publikohen në faqen zyrtare të Institucionit. **Studentët që morrën pjesë në takim nuk kishin dijeni mbi rezultatet e pyetësorit dhe kjo është një pikë mbi të cilën Institucioni duhet të punoj më shumë.** Në bazë të rezultateve ndërmerren hapa për përmirësimin e problematikave u raportua nga NJSBC si dhe stafi akademik. Hapat prezantohen tek raporti vjetor i Institucionit dhe i Njesisë Kryesore. **GVJ konsideron të rëndësishme hartimin e një plani masash specifik mbi rezultatet e pyetësorit duke vendosur objektiva dhe mënyra matëse të rezultateve të pritshme.**

Evidenca:

Nr. 64 Raport Vjetor UAMD 2020-2021;

Nr. 70. Analiza vjetore e FSP 2020- 2021;

	<p><i>Nr. 106 Formular tip vleresim stafi nga studentet;</i></p> <p><i>Nr. 107 Anketimi i studenteve;</i></p> <p><i>Nr. 107.1 Rezultate anketimi;</i></p> <p><i>Nr. 108 Transparenca e Rezultateve te Anketimeve te Studenteve;</i></p> <p><i>Takimi me studentët;</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>UAMD ka hartuar një udhëzues për stafin akademik me titull “Aftësim për mësimdhënie ndërvepruese”. Synimi i këtij manuali është: rritja e cilësisë së mësimdhënies në auditorët e arsimit të lartë në UAMD dhe në institucione të tjera të ngjashme në Shqipëri. Institucion ka ngritur NJSBC e cila harton standardet për sigurimin e cilësisë së brendshme në përputhje me Kodin e Cilësisë. Njësia realizon vlerësime periodike për veprimtarinë mësimore dhe kërkimore shkencore. Detyrë integrale e kësaj njësie është gjithashtu realizimi i pyetësorit të studentëve çdo fund semestri, mbi cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi të ofruara nga IAL. NJSBC është pjesë e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Standarteve të Cilësisë e cila sipas rregullores se saj është përgjegjëse për monitorimin dhe zhvillimin akademik të stafit.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 24 Raporti i sigurimit te cilesise UAMD;</i></p> <p><i>Nr. 33 Struktura UAMD 2019;</i></p> <p><i>Nr. 33.1 Organograma e UAMD, Programet UAMD;</i></p> <p><i>Nr.43 Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve;</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Sipas Rregullores së Programit të studimeve (neni 10), në programin e ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në “Infermieri e Përgjithshme” çdo lëndë mësimore organizohet si ndërthurje e elementëve të përcaktuar në aktet nënligjore në fuqi. UAMD ka hartuar një udhëzues për stafin akademik me titull “Aftësim për mësimdhënie ndërvepruese”. Institucioni mbështet stafin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike përmes formave të ndryshme ndërsa studentët janë të përfshirë në këtë proces. GVJ konsideron të rëndësishme hartimin e një plani masash specifik mbi rezultatet e pyetësorit duke vendosur objektiva dhe mënyra</i></p>

	<i>matëse të rezultateve të pritshme. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Neni 50 i Rregullores së Njesisë Kryesore përcakton mënyrën/at e kontrollit të dijeve. Forma e vetme e kontrollit të dijës në Fakultetin e Studimeve Profesionale është provimi me shkrim. Për çdo kurs 10% e vlerësimit bazohet në detyrat e kursit, projektet individuale apo në grupe, dhe esetë, sipas programit të lëndës së miratuar. Në format e kontrollit përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit kthehet në note sipas formulës së përcaktuar me vendim të Senatit Akademik. Neni 67 i Rregullores së Njesisë Bazë detajon mënyrën e vlerësimit të njohurive. Neni 38 i Rregullores së Programit të Studimeve përcakton mënyrën e vlerësimit të dijeve. Format e kontrollit të dijeve në programin e ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme”, në Departamentin e Shkencave Teknike Mjekësore janë provimi me shkrim, me gojë, me detyra kursi/projekte, i kombinuar, me kontroll dhe vëzhgim. Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen, në programin e lëndës dhe të Praktikës Profesionale dhe i bëhen të ditura studentëve në orën e parë të mësimin. Vlerësimi në një lëndë dhe në Praktikën Profesionale mund të bëhet: a. me provim me shkrim, me gojë ose i kombinuar; b. me detyra kursi, projekte; c. me kontroll dhe vëzhgim. Rregulloret janë të aksesueshme në faqen zyrtare të Institucionit. Është e nevojshme që të korrigjohen mospërputhjet midis Rregullores së Njesisë Kryesore ku thuhet se provimi me shkrim është e vetmia metodë e kontrollit të dijeve ndërsa Rregullorja e Programit të studimit përmban dhe metoda të tjera.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 08 Rregullore e Njesisë Kryesore;</i></p> <p><i>Nr. 09 Rregullore e Njesisë Bazë;</i></p>

	<i>Nr. 10 Rregullore e Programit të studimit.</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Studentët orën e parë të lëndës informohen nga pedagogu respektiv mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Ky informacion është po ashtu edhe në syllabuset e lëndëve. Informimi i studentëve orën e parë të modulit u konfirmua dhe gjatë takimeve si nga stafi akademik po ashtu dhe nga studentët.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.123 Syllabuset Infermieri e Përgjithshme v.a. 2019-2020;</i></p> <p><i>Nr.124. Syllabuset Infermieri e Përgjithshme v.a. 2020-2021;</i></p> <p><i>Nr.124.1 Syllabuset Infermieri e pergjithshme v.a. 2021-2022;</i></p> <p><i>Takimi me stafin akademik;</i></p> <p><i>Takimi me studentët.</i></p>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>Neni 38 i Rregullores së Programit të Studimeve përcakton mënyrën e vlerësimit të dijeve. Format e kontrollit të dijeve në programin e ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme”, në Departamentin e Shkencave Teknike Mjekësore janë provimi me shkrim, me gojë, me detyra kursi/projekte, i kombinuar, me kontroll dhe vëzhgim. Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen, në programin e lëndës dhe të Praktikës Profesionale dhe i bëhen të ditura studentëve në orën e parë të mësimin. Vlerësimi në një lëndë dhe në Praktikën Profesionale mund të bëhet: a. me provim me shkrim, me gojë ose i kombinuar; b. me detyra kursi, projekte; c. me kontroll dhe vëzhgim. Rregulloret janë të aksesueshme në faqen zyrtare të Institucionit. Në të gjitha format e kontrollit të lëndëve dhe të Praktikës Profesionale përdoret sistemi i vlerësimit me 1000 pikë, vlera përkatëse detyrimisht konvertohet (kthehet) në notë sipas formulës së përcaktuar me vendim të Senatit Akademik. Vlerësimi për secilën lëndë dhe për Praktikën Profesionale kryhet pas përfundimit të saj me sistemin e pikëve (1000 pikë totali), i cili konvertohet në sistemin e notave, nga nota minimale 4 deri në notën maksimale 10. Nota kaluese më e ulët është nota pesë e cila korespondon me 51% të pikëve të fituara. Vlerësimi përfundimtar bazohet në: a) Provimi/kontroli i parë i ndërmjetëm, i cili zhvillohet në javën e shtatë dhe/ose të tetë të semestrit, përmban 400 pikë ose 40% të vlerësimit përfundimtar; b) Provimi/kontroli përfundimtar, i cili zhvillohet në javën e pesëmbëdhjetë dhe/ose të</p>

	<p>gjashtëmbëdhjetë të semestrit, përmban 500 pikë ose 50% të vlerësimit përfundimtar; c) Detyrat, projektet, esetë, maketet, etj, të cilat zhvillohen gjatë gjithë semestrit, aktivizimi gjatë orëve të mësimi, frekuentimi i lëndës, referimi i punimit të Praktikës Profesionale përmbajnë 100 pikë ose 10% të vlerësimit përfundimtar. Studenti vlerësohet për Praktikën Profesionale pas përfundimit të saj me sistemin e pikëve (1000 pikë totali), i cili konvertohet në sistemin e notave, nga nota minimale 4 deri në notën maksimale 10. Nota kaluese më e ulët është nota pesë e cila korespondon me 51% të pikëve të fituara. Vlerësimi për Praktikën Profesionale bëhet me kontroll dhe vëzhgim (neni39). Format dhe mënyrat e ndryshme të testimit janë të prezantuara dhe në syllabuset përkatëse.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e Programit të studimit;</i></p> <p><i>Nr.124.1 Syllabuset Infermieri e pergjithshme v.a. 2021-2022.</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>UAMD ka hartuar një udhëzues për stafin akademik me titull “Aftësim për mësimdhënie ndërvepruese”. Studentët përfshihen në vlerësimin e mësimdhënies përmes pyetësorit të orgnizuar nga NJSBC. Institucion ka miratuar dhe implementon një formular vetvlerësimi të pedagogëve. Performanca e stafit akademik me kohë të caktuar po ashtu vlerësohet nga Drejtuesi i Njesisë Bazë. Në takimin me Drejtuesen e Departamentit u raportua se stafi akademik nuk vlerësohet nga Drejtuesi i Njesisë. GVJ konsideron sit ë rëndësishme hartimin e një procedure ku stafi akademik me kontrat me afat të pa caktuar të vlerësohet të paktën një herë në vit nga Drejtuesi i Njesisë Bazë.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 24 Raporti i sigurimit te cilesise UAMD;</i></p> <p><i>Nr.43 Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve;</i></p> <p><i>Nr. 78 Modele për Vlerësimin e Performancës së Pedagogut; Takim me Drejtuesen e Departamentit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme</p>	<p>Pedagogët gëzojnë autonomi dhe liri akademike për të implementuar metoda të ndryshme pedagogjike me qëllim krijimin e një ambienti miqësor dhe të përshtatshëm për</p>


<p>dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>studentët. Pedagogët raportuan gjatë takimit se mundohen të zhvillojnë mësimdhënien me në qendër studentin. Studentët raportuan gjatë takimit se kanë mundësinë të shprehin mendimet e tyre gjatë leksioneve/seminareve.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 44 Dëshmi e respektimit të autonomisë dhe lirise akademike dhe financiare;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik;</i></p> <p><i>Takim me studentët.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Neni 38 i Rregullores së Programit të Studimeve përcakton mënyrën e vlerësimit të dijeve. Format e kontrollit janë provimi me shkrim, me gojë, me detyra kursi/projekte, i kombinuar, me kontroll dhe vëzhgim. Institucion ka miratuar dhe implementon një formular vetvlerësimi të pedagogëve. Performanca e stafit akademik me kohë të caktuar po ashtu vlerësohet nga Drejtuesi i Njesisë Bazë. GVJ konsideron si të rëndësishme hartimin e një procedure ku stafi akademik me kontrat me afat të pa caktuar të vlerësohet të paktën një herë në vit nga Drejtuesi i Njesisë Bazë. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.3</p> <p>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të</p>	<p>Testimi zhvillohet gjatë gjithë semestrit në një lëndë. Provimi me shkrim, me gojë, me detyra kursi/projekte, i kombinuar, me kontroll dhe vëzhgim janë disa nga mënyrat e vlerësimit të dijeve dhe njohurive të studentëve. Për çdo lëndë 10% e vlerësimit bazohet në detyrat e kursit, projektet individuale apo në grupe, esetë, maketet, etj, sipas programit të lëndës së miratuar. Provimi i parë/ndërmjetëm i cili zhvillohet javën e</p>




<p>parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>shtatë ose të tetë përmban 40% të vlerësimit përfundimtar. Mënyra e vlerësimit parashikohet edhe në syllabuset e secilës lëndë. Vlerësimi i vazhduar u raportua dhe në takimet me stafin akademik dhe studentët.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e Programit të studimit;</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik;</i></p> <p><i>Takim me studentët.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Me qëllim përmirësimin e transparencës UAMD ka nënshkruar me AADF marrveshje për implementimin e projektit CleanScore. Ky projekt ka si qëllim korrigjimin dhe vlerësimin e tezave të studentëve në mënyrë anonime dhe elektronike. Implementimi i kësaj marrveshje ul mundësinë e abuzimeve si dhe rit transparencën.</p> <p>Përdorimi i këtij sistemi u konfirmua dhe nga pedagogët gjatë takimit të zhvilluar. Kjo është një praktikë e mirë të cilën UAMD duhet ta vazhdoj. GVJ vlerëson të rëndësishme që kjo mënyrë korrigjimi të pasqyrohet edhe në syllabuset e pedagogëve pasi diçka e tillë mungon.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 137 Marrveshje me Clean Score. trajnimi Clean Score.</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Pedagogët dhe studentët konfirmuan se vlerësimi përfundimtar i lëndës zhvillohet në përputhje me statutin (neni 61), rregulloren e UAMD (neni 68), rregulloren e Njesisë Kryesore (neni 50), rregulloren e Njesisë Bazë (neni 67) dhe rregulloren e programit të studimit (neni 38).</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 04 Statuti i UAMD;</i></p> <p><i>Nr. 05 Rregullore e UAMD;</i></p> <p><i>Nr. 08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale;</i></p> <p><i>Nr. 09 Rregullore e Departamenteve Shkencave Teknike Mjekësore;</i></p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e programi të studimit Infermieri e pergjithshme.</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse</p>	<p>Personeli akademik i lëndës (lektori dhe asistent-lektori i lëndës nëse ka) j'u komunikojnë studentëve pikët e vlerësimit të provimit/kontrollit të ndërmjetëm, përfundimtar dhe të detyrave/projekteve, etj, si dhe notën përfundimtare me të cilën janë vlerësuar në këtë lëndë, apo në Praktikën</p>

<p>është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Profesionale (neni 43). Rezultatet e provimit ju bëhen me dije studentëve përmes platformës elektronike PITAGORA. Paralelisht Brenda 72 orëve pas provimit të zhvilluar, pedagogu i lëndës diskuton në klasë me studentët paqartësitë apo edhe gabimet e tyre. Kjo procedurë u konfirmua edhe nga studentët gjatë takimit me ta. GVJ konsideron si një procedurë shumë të rëndësishme konsultimet që pedagogët zhvillojnë me studentët pas përfundimit të provimit dhe rekomandon përfshirjen e kësaj procedure në rregulloren e programit të studimeve (neni 43, pika 4 duhet të zgjerohet).</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e programi të studimit Infermieri e përgjithshme;</i></p> <p><i>Nr.32 Sistemi PITAGORA (RASH);</i></p> <p><i>Takimi me studentët.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Neni 56 i rregullores së programit të studimit përcakton shkeljet disiplinore përfshirë këtu kopjimin në provime. Rregullat e provimit janë të pasqyruara në Rregulloren e Njësisë Bazë (neni 59) si dhe në nenin 52 të Rregullores së Njësisë Kryesore. Nuk u raportua përdorimi i ndonjë sistemi antiplagjiature nga Njësia Bazë dhe GVJ e konsideron të rëndësishme përdorimin e një sistemi të tillë.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale;</i></p> <p><i>Nr. 09 Rregullore e Departamentite Shkencave Teknike Mjekësore;</i></p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e programi të studimit Infermieri e përgjithshme.</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Procesverbali i Vlerësimit (neni 44) plotësohet nga pedagogu/pedagogët në përfundim të procesit të vlerësimit dhe dorëzohet në sekretari jo më vonë se 7 ditë nga dita e provimit/kontrollit të ndërmjetëm dhe jo më vonë se 72 orë nga dita e provimit/kontrollit përfundimtar ose e provimit të formimit/prezantimit të tezës së diplomës. Procesverbali i provimit/kontrollit të ndërmjetëm, procesverbali me notat përfundimtare dhe procesverbali me notat e Mbrojtjes së Diplomës nënshkruhen nga personeli akademik pedagogu/pedagogët e lëndës/Praktikës Profesionale apo Komisioni i Mbrojtjes së Diplomës, Sekretarja mësimore,</p>




	<p>Kryesekretarja, Drejtuesi i Njesisë Bazë (Përgjegjësi i DSHTM) dhe Drejtuesi i Njesisë Kryesore (Dekani). Përdorimi i sistemit CleanScore rrit transparencën dhe përmirëson korrigjimin bazuar në merit.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e programi te studimit bachelor në "Infermieri e Përgjithshme"</i></p> <p><i>Nr. 137 Marreveshje me Clean Score trajnimi Clean Score.</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Studentët njoftohen për rezultatet e provimit në kohë sipas procedurave të përcaktuara në aktet e Institucionit. Neni 43 i Rregullores së Programit të studimeve përcakton qartë mënyrën dhe detyrën e Institucionit tu komunikoj studentëve vlerësimin. Neni 60 i Rregullores së Njesisë Bazë dhe neni 53 i Rregullores së Njesisë Kryesore përcakton afatet kohore si dhe procedurën e duhur për ankimimin e një note apo/ose të rregullave të zhvillimit të provimeve. Informacione mbi të drejtën e ankimimit paraqitet edhe në neni 71 të Rregullores së UAMD.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 05 Rregullore e UAMD;</i></p> <p><i>Nr. 08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale;</i></p> <p><i>Nr. 09 Rregullore e Departamentite Shkencave Teknike Mjekësore;</i></p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e programi te studimit Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme".</i></p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin. Ankesa i drejtohet me shkrim Drejtuesit të Njesisë Kryesore ku bën pjesë student i jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve. Në rastin kur kërkesa miratohet, Dekani ngrre një komision ad-hoc për rishikimin e tezës nëse lënda mbulohet nga vetë Departamenti. Në rast se lënda mbulohet nga një njësi tjetër kryesore, Drejtuesi i Njesisë Kryesore i kërkon kësaj njësie përbërjen e komisionit të ngritur nga Drejtuesi i asaj njësie. Përgjegjësi i Departamentit përcakton ditën dhe orën se kur do mblidhet komisioni ad-hoc jo më vonë se 3 ditë nga miratimi i kërkesës dhe njofton për këtë orar personelin akademik të seksionit dhe studentin. Rishikimi i tezës nga komisioni ad-hoc realizohet në prezencë të studentit dhe personelit akademik të seksionit nëse këta paraqiten në orarin e përcaktuar. Në përfundim të procesit, komisioni mban një</p>

	<p>procesverbal të veçantë ku pasqyron vendimin e tij për të ndryshuar ose jo vlerësimin e provimit së bashku me arsyetimin përkatës. Në rast se ka ndryshim në vlerësimin e provimit atëhere ky ndryshim duhet të pasqyrohet në procesverbalin e lëndës duke ndjekur procedurat e përcaktuara.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale;</i></p> <p><i>Nr. 09 Rregullore e Departamentit të Shkencave Teknike Mjekësore.</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Testimi zhvillohet gjatë gjithë semestrit në një lëndë. Provimi me shkrim, me gojë, me detyra kursi/projekte, i kombinuar, me kontroll dhe vëzhgim janë disa nga mënyrat e vlerësimit të dijeve dhe njohurive të studentëve. Pedagogët dhe studentët konfirmuan se vlerësimi përfundimtar i lëndës zhvillohet në përputhje me aktet e brendshme. Personeli akademik i lëndës (lektori dhe asistent-lektori i lëndës nëse ka) u komunikojnë studentëve pikët e vlerësimit të provimit/kontrollit. Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimit. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Në bazë të planit mësimor, programi i studimit Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme” ka si qëllim rritjen e njohurive dhe aftësive të studentëve me qëllim përgatitjen e tyre sa më adekuate për tregun e punës. Studentët përmes praktikave të cilat zhvillojnë përfitojnë aftësi të veçanta për ti implementuar ato me pacientë në shërbimet shëndetësore.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.121 Dosja e programit te studimit (kurikula, plani mesimor, dhe personeli akademik);</i></p>

	<i>Tabela 9 Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E).</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	<p>Programi i studimit përfshin lëndë si Sociologji/Psikologji, Gjuhë të Huaj, Ekonomi & Menaxhimi Shendetesor dhe Statistikë. Mungojnë lëndë të cilat fokusohen në Informatikën Shëndetësore apo në Komunikimin Efektiv midis mjek/infermier/pacient. <u>GVJ rekomandon përfshirjen e lëndëve të cilat do të fokusohen në këto fusha.</u></p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.121 Dosja e programit të studimit (kurikula, plani mesimor, dhe personeli akademik);</i></p> <p><i>Tabela 9 Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E).</i></p>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	<p>Në përfundim të modulti/lëndës pedagogu/ët respektiv të lëndëve u paraqesin studentëve dhe i orjentojnë ata mbi çështjet më të rëndësishme si dhe ku të fokusohen për provimin respektiv. Kjo procedurë u konfirmua nga stafi akademik dhe studentët gjatë takimeve të zhvilluara në Institucion.</p> <p>GVJ e konsideron këtë si një praktikë të mirë dhe sugjeron përfshirjen e kësaj procedure në rregulloren e programit të studimit edhe/ose në syllabuset e lëndëve respektive.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Takimi me stafin akademik;</i></p> <p><i>Takimi me studentët.</i></p>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime	<p>Përveç orëve të leksioneve, studentët në programin e studimit Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme" zhvillojnë seminare, laboratore, praktika profesionale etj me qëllim përfitimim e kompetencave të cilat o ti praktikojnë gjatë ushtrimit të profesionit. Personeli akademik raportoi se mbështet diskutimet në klasë si dhe u jep mundësinë studentëve të mendimit kritik.</p> <p>Pavarësisht numrit të marrëveshjeve që ka Institucioni, asnjë nga studentët që morën pjesë në takim nuk kishte zhvilluar mobilitet.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.34 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD;</i></p> <p><i>Nr.36 Mobiliteti stafit+studente UAMD;</i></p>

të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	<p><i>Nr.96 Tabela me Marrëveshjet e Bashkëpunimit të FSP;</i></p> <p><i>Nr.121 Dosja e programit të studimit (kurrikula, plani mesimor, dhe personeli akademik);</i></p> <p><i>Tabela 9 Plani mesimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E).Takimi me stafin akademik;</i></p> <p><i>Takimi me studentët.</i></p>			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	<p>Orë të hapura dhe seminare organizohen rregullisht nga Njësia Bazë si dhe nga UAMD. Këto aktivitete kanë si qëllim informimin e stafit akademik dhe studentëve mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.71 Buletini i aktiviteteve-FSP-2021-2022;</i></p> <p><i>Nr.73 Raport mbi Aktivitetet Kulturore, Shkencore dhe Artistike.</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Në bazë të planit mesimor, programi i studimit Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme" ka si qëllim rritjen e njohurive dhe aftësive të studentëve me qëllim përgatitjen e tyre sa më adekuate për tregun e punës. Mungojnë lëndë të cilat fokusohen në Informatikën Shëndetësore apo në Komunikimin efektiv midis mjek/infermier/pacient. Orë të hapura dhe seminare organizohen rregullisht nga Njësia Bazë si dhe nga UAMD. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të	Organizimi dhe zhvillimi i diplomimit paraqiten në nenin 58 të Rregullores së Njesisë Kryesore. Neni 24 i Rregullores së Programit të Studimit përcakton se në bazë të kriterit të notës mesatare dhe/ose kritere të tjera, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar diplomimi. Studentët të cilët plotësojnë kushtet, duhet të paraqesin pranë Sekretarisë Mësimore të FSP, "Kërkesën për

<p>drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>t'u regjistruar në Provimin/Temën e Diplomës" të plotësuar, sipas formatit të miratuar, të paktën 2 javë nga data e shpallur nga FSP për zhvillimin e provimit të diplomimit ose për mbrojtjen e temave të diplomës. Nenet 33-37 të kësaj rregullore përcaktojnë procedurat dhe rregullat e përgjithshme mbi temën e diplomës. Nent 62-64 të Rregullores së Njesisë Bazë përcaktojnë rregullat për mbrojtjen e diplomës. Paralelisht, Njësia Bazë ka hartuar një Rregullore të posaçme për mikrotezën por në nivel Masteri.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale;</i></p> <p><i>Nr. 09 Rregullore e Departamentite Shkencave Teknike Mjekësore;</i></p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e programi te studimit Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme".</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Studentët të cilët plotësojnë kushtet, duhet të paraqesin pranë Sekretarisë Mësimore të Fakultetit, "Kërkesën për tu regjistruar në Provimin/Temën e Diplomës" të plotësuar, sipas formatit të miratuar, të paktën 2 javë nga data e shpallur nga njësia kryesore për zhvillimin e provimit të diplomimit dhe mbrojtjen e temave të diplomës. Departamenti përcakton listën e temave të diplomave në fillim të semestrit të dytë të vitit akademik. Ky përcaktim bëhet duke u mbështetur në fushat e studimit që mbulon Departamenti. Drejtuesit e tezave të diplomës propozohen nga DSHTM dhe miratohen nga Dekani. Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dita e fillimit të semestrit të dytë, Departamenti u bën të njohur studentëve të vitit të fundit programet e provimit të përgjithshëm përfundimtar të diplomimit. Drejtuesi i Njesisë Bazë propozon Komisionet e Provimit të Diplomimit (KPD) për çdo program studimi që mbulon Departamenti, të cilat miratohen nga Dekani. KPD, nëpërmjet sekretarisë mësimore, informon studentët rreth organizimit të provimeve të diplomimit.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale;</i></p> <p><i>Nr. 09 Rregullore e Departamentite Shkencave Teknike Mjekësore;</i></p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e programi te studimit Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme".</i></p>




<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Drejtuksi i Njësisë Bazë, për çdo program propozon ngritjen e një komisioni për provimin e përgjithshëm përfundimtar të diplomimit i përbërë nga të paktën 3 (tre) anëtarë të personelit akademik. Nota përfundimtare llogaritet si mesatare e të gjitha notave të anëtarëve të komisionit, të cilat pasqyrohen në procesverbal, dhe i bëhet e ditur studentit jo më vonë se 72 orë nga përfundimi i provimit. Lëndët që do të përfshihen si dhe formati i tezës së provimit të përgjithshëm përfundimtar të diplomimit përcaktohen në rregulloren e programit të studimit. Në rregulloren e programit të studimit (neni 41 pika 3) nuk përcaktohen lëndët si dhe formati i tezës së provimit dhe për këtë arsye GVJ rekomandon rishikimin e kësaj rregullore.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale;</i></p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e programi te studimit Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme".</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Në mënyrë që studenti ta kryejë sa më mirë këtë temën e diplomës, ai udhëhiqet nga një lektor i UAMD, i brendshëm ose i jashtëm, të koordinuar nga departamenti përkatës dhe të miratuar nga Këshilli i Fakultetit. Udhëheqësi i diplomës zgjidhet duke pasur parasysh disa kritere specifike (Neni 33 pika 2 e Rregullores së Programit të studimit). Udhëheqsi zhvillon takime periodike me studentin, e orienton dhe e asiston gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të temës së tij. Për studentët e Masterit të cilët janë të detyruar të hartojnë temën e diplomës është me e detajuar sipas rregulloreve të miratuara.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale;</i></p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e programi te studimit Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme";</i></p> <p><i>Nr. 97 Rregullore e Mikrotezës në Fakulteti i Studimeve Profesionale;</i></p> <p><i>Nr. 97.1 Rregullore e mikrotezes dhe provimit final DSHTM.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Në bazë të nevojave, Institucioni asiston studentët gjatë procesit të temës së tyre. Asistimi mund të ketë të bëjë me hartimin e dokumentacionit për marrjen e lejes etike deri në përdorimin e ambienteve të Institucionit në bazë të nevojave të studentëve. Paralelisht, përmes marrveshjeve të bashkëpunimit, studentët kanë mundësinë të zhvillojnë temën e diplomës në institucione të tjera (psh. Spitale, qendra</p>

	<p>shëndetësore etj.). Kjo u konfirmua edhe nga stafi akademik në takimin e zhvilluar.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 94 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të DSHTM;</i></p> <p><i>Takimi me stafin akademik.</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Vlerësimi i tezës së diplomës bëhet me notë nga një komision, përbërja e të cilit propozohet dhe miratohet nga Dekani. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë. Mbrojtja përpara komisionit është e hapur dhe studenti ka të drejtë të referojë punimin e tij, në jo më pak se 20 minuta. Anëtarët e komisionit dhe dëgjuesit në sallë, rezervojnë të drejtën për t'i drejtuar pyetje studentit në lidhje me tezën e diplomës. Vlerësimi për provimin e përgjithshëm përfundimtar të diplomimit bëhet nga një komision, përbërja e të cilit propozohet nga DSHTM dhe miratohet nga Dekani. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë të DSHTM. Nota përfundimtare llogaritet si mesatare e të gjitha notave të anëtarëve të komisionit, të cilat pasqyrohen në procesverbal, dhe i bëhet e ditur studentit nga Komisioni, jo më vonë se 72 orë nga përfundimi i provimit.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e programi te studimit Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme".</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomën ose çertifikatën përkatëse. Elementet përbërëse, forma e diplomës dhe procedurat për regjistrimin përcaktohen nga ministria përgjegjëse për arsimin. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Ai përshkruan, në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 05 Rregullore e UAMD;</i></p> <p><i>Nr. 08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale;</i></p>
	<p><i>Nr. 09 Rregullore e Departamentite Shkencave Teknike Mjekësore;</i></p> <p><i>Nr. 10 Rregullore e programi te studimit Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme".</i></p>

<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Kopje e dokumentacionit të studentit ruhet në bazë të legjislacionit në fuqi. Kopje e këtij dokumentacioni ju paraqit dhe GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mësimore.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 04 Statuti i UAMD;</i></p> <p><i>Nr. 05 Rregullore e UAMD;</i></p> <p><i>Vizita në sekretarinë mësimore.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Organizimi dhe zhvillimi i diplomimit paraqiten në nenin 58 të Rregullores së Njësisë Kryesore. Drejtuesit e tezave të diplomës propozohen nga DSHTM dhe miratohen nga Dekani. Në bazë të nevojave, Institucioni asiston studentët gjatë procesit të temës së tyre. Asistimi mund të ketë të bëjë me hartimin e dokumentacionit për marrjen e lejes etike deri në përdorimin e ambienteve të Institucionit në bazë të nevojave të studentëve. Nota përfundimtare llogaritet si mesatare e të gjitha notave të anëtarëve të komisionit, të cilat pasqyrohen në procesverbal, dhe i bëhet e ditur studentit jo më vonë se 72 orë nga përfundimi i provimit. Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomën ose certifikatën përkatëse. Kopje e dokumentacionit të studentit ruhet në bazë të legjislacionit në fuqi. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p>Standardi IV.1</p> <p>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>




Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Njësia kryesore përgjegjëse për programin ka angazhuar gjatë vitit akademik 2022-2023 48 staf akademik, nga të cilët 18 janë staf akademik me kohë të plotë dhe 30 janë të angazhuar si staf akademik me kohë të pjesshme si dhe 2 staf ndihmës akademik.

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Studimeve Profesionale	
	PAE	PAK
Prof.Dr	-	-
Prof.Asoc	3	-
Dr/PhD	11	9
Msc	4	21
Gjithsej	18	30

Sipas evidencave shoqëruese te raportit të vlerësimit të brendshëm vihet re nga GVJ se institucioni mban të dhëna të plota mbi personelin e angazhuar në këtë program studimi, i cili në përgjithësi është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë tre viteve akademike paraqiten si vijon:

Në tabelat shoqëruese të RVB si dhe CV e personelit akademik jepet një informacion i detajuar mbi numrin dhe cilësitë e personelit akademik të përfshirë në programin e studimit Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme”.

Viti akademik	PAE		PAK	
	Nr.	Titulli/Grada	Nr.	Titulli/Grada
2019-2020	1	Prof.Dr.		
	11	Dr.	5	Dr.
	2	(PhD/Dr. në proçes)		
	2	Msc.	12	Msc.
	2	Msc.Spa	12	Msc.Spa
2020-2021	1	Prof.Dr.		
	11	Dr.	6	Dr.
	2		2	(Dr. në proçes)

	2	(PhD/Dr. në proçes)	6	Msc.
	2	Msc.	9	Msc.Spa
		Msc.Spa		
2021-2022	1	Prof.Dr.		
	2	Prof.As.		
	11	Dr.	6	Dr.
	1	(Dr. në proçes)	2	(Dr. në proces)
	1	Msc.	10	Msc.
	2	Msc.Spa.	7	Msc.Spa.

Referuar *ngarkesës mësimore*, mbulimi i orëve mësimore në auditor për këtë vit akademik është mbuluar kryesisht nga personeli me kohë të plotë

Nga shqyrtimi i CV të personelit akademik, GVJ konstatoi se stafi i angazhuar në këtë program studimi ka fushë kërkimore në përputhjen me natyrën dhe veçoritë e lëndëve të ofruara në këtë program studimi.

Në funksion të programit të studimit, sikurse edhe për programe të tjera të studimit që ofrohen nga fakulteti, Institucioni ka angazhuar një personel ndihmës akademik, si sekretare dekani, sekretar departamentesh, sekretare mësimore dhe laborant IT, për të suportuar aktivitetin mësimor dhe kërkimor të departamentit dhe të institucionit në përgjithësi nëpërmjet kryerjes së detyrave të ndryshme për të cilat ka nevojë stafi akademik. GVJ vlerëson se **personeli akademik që angazhohet në këtë program studimi ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për mësimdhënien dhe mbulimin e të gjitha aktiviteteve bashkëshoqëruese të një programi studimi Bachelor, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.**

Evidenca:

	<i>Nr.74 Tabelat ASCAL dega Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme"</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	<p>Nga verifikimi i të dhënave statistikore (ref. Tabelave 12.1, 12.2,12.3), u konstatua se për tre vitet akademike mbi 70% e ngarkesës mësimore është mbajtur nga personeli akademik efektiv, PAE.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.74 Tabelat ASCAL dega Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme"</i></p> <p><i>Nr.76 Të dhëna tabelare për personelin akademik të DSHTM (ngarkesa e stafit, cilesia e stafit, kërkimi shkencor i stafit)</i></p> <p><i>Nr.80 Të dhëna tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik në të gjitha programet e studimit të DSHTM v.a. 2019-2020</i></p> <p><i>Nr.80.1 Të dhëna tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik në të gjitha programet e studimit të DSHTM v.a. 2020-2021</i></p> <p><i>Nr.80.2 Të dhëna tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik në të gjitha programet e studimit të DSHTM v.a. 2021-2022</i></p> <p><i>Nr.81 CV te Stafit Akademik dhe Ndhmës Akademik të DSHTM</i></p>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	<p>Në bazë të dokumentave të paraqitura dhe takimeve të kryera gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se UAMD ka një eksperiencë shumë të mirë në punësimin e një stafi cilësor me dëshirë për t'u kualifikuar, dhe që demonstroi qëndrueshmëri në vite.</p> <p>GVJ konstaton se gjatë tre viteve të fundit akademike, të shqyrtuara për akreditim, personelin akademik i angazhuar në këtë program studimi është zgjeruar, dhe në përgjithësi stafi nuk ka ndryshuar, një përqindje shumë e lartë e stafit akademik efektiv të angazhuar gjatë vitit 2020-2021 ka vazhduar të angazhohet edhe në dy vitet e ardhshme akademike.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.74 Tabelat ASCAL dega Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme"</i></p> <p><i>Nr.82 Procedura e rekrutimit</i></p>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur	Procesi i rekrutimit është i parashikuar në Statutin e Universitetit UAMD në bazë të legjislacionit në fuqi, ku përcakton kriteret dhe procedurat që ndiqen në rekrutimin e




<p>në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>personelit akademik me kohë të plotë (neni 45), me kohë të pjeshme (neni 46), i ftuar (neni 47) dhe ndihmës akademik (neni 52).</p> <p>Sipas Statutit dhe rregullores së UAMD (Kreu V) përzgjedhja e personelit akademik me kohë të plotë bëhet me konkurim në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Kërkesat për staf të ri adresohen nga Departamenti në bazë të nevojave të tij, në kërkesë përcaktohen kriteret specifike për vendet vakante të cilat miratohen nga rektori. Universiteti shpall konkursin për vende të lira pune, sipas strukturës së përgjithshme në nivel institucional, të miratuar nga Bordi i Administrimit dhe kryhet publikimi në Buletinin e Njoftimeve Publike në formë të shkruar dhe elektronike. Gjithashtu, njoftimet publikohen edhe në faqen zyrtare të institucionit, së bashku me formularët e aplikimit. Procesi vijon me mbledhjen e kandidaturave, shqyrtimin e dosjeve nga Komisioni i ngritur posaçërisht, nga të cilët jo më pak se tre përfaqësues të njësisë bazë. Vlerësimi i aplikantëve bëhet në dy faza: vlerësimi i dosjes dhe intervista. Vetëm kandidatët e kualifikuar nga faza e shqyrtimit të dosjeve i nënshkrohen intervistës, sipas një strukture pikësimi të përcaktuar qartë në rregulloren e rekrutimit të personelit akademik. Dosja e aplikantit vlerësohet maksimumi me 70% të totalit të pikëve, ndërsa 30% i pikëve i akordohet intervistës. Komisioni bën renditjen e kandidatëve sipas pikëve të fituara në total. Rekrutimi i pedagogëve me kohë të pjeshme ndjek të njëjtën procedure si edhe stafi akademik me kohë të plotë.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.4 Statuti i UAMD</i> <i>Nr.93 Rregullore e UAMD</i> <i>Nr.83 Kontrate individ pune tip</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>UAMD ka angazhuar personel administrativ dhe ndihmës akademik në nivel njësie kryesore, të cilët angazhohen në mirëmbajtjen e pajisjeve didaktike, të laboratorëve dhe ambienteve të tjera mësimore. Përsa i përket mirëmbajtjes së laboratorëve, zyra e TI-së ndjekë realizimin e orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.74 Tabelat ASCAL dega Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme".</i></p>




<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>UAMD në organigramën e tij, ka pjesë të strukturës së tij Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Juridike, e cila funksionon në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodin e Punës, Kodin e Proçedurave Administrative, Ligjin Nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe Statutin e UAMD.</p> <p>GVJ konstatoi se kjo zyrë plotëson, ruan dhe përditëson të dhënat mbi anëtarët e personelit akademik të angazhuar në programet e studimit që ofron UAMD në formën e dosjeve personale të personelit. Sektori i Burimeve Njerëzore është përgjegjës për realizimin e rekrutimeve për personelin akademik, administrativ dhe ndihmës mësimor – shkencor të institucionit dhe për administrimin e dosjeve të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrative.</p> <p>Në mënyrë rastësore, GVJ shqyrtoi dosjen personale të dy pedagogëve të programit të studimit (një me kohë të plotë dhe një me kontratë) dhe konstatoi se dosja ishte e plotësuar me dokumentet e nevojshëm si: CV, kontrata e punës, diplomat dhe kualifikimet, librezat shëndetësore etj.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Evidencë Nr.18 Rregullore Drejtoria e admin. e shërbime akademike</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Pjesë e UAMD është një zyrë e veçantë për udhëzimin drejt karrierës dhe për praktikat profesionale. Kjo zyrë ka krijuar marrëveshje me institucione të ndryshme, të cilat mundësojnë realizimin e praktikave profesionale për studentët. Për realizimin e praktikës profesionale UAMD ka lidhur 61 marrëveshje bashkëpunimi (tabela nr. 5) në nivel institucioni dhe njësie kryesore me përfaqësues të institucioneve publike dhe të bizneseve private, të cilat u mundësojnë edhe realizimin e praktikave profesionale studentëve të këtij programi studimi.</p> <p>Zyra e Karrierës kujdeset për parapërgatitjen e studentëve për procesin e praktikave mësimore dhe për orientimin e tyre në organizatat/kompanitë/institucionet ku do të zhvillojë praktikën. Praktika profesionale është e integruar në një lëndë specifike e Internshipit në semestrin e dytë të vitit të tretë të studimeve. Plani mësimor i programit të studimit parashikon 85 orë në auditor dhe 90 orë jashtë auditorit për realizimin e praktikës profesionale.</p>




	<p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.34 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD</i> <i>Nr.74 Tabelat ASCAL dega bachelor Infermieri e pergjithshme</i> <i>Nr.133 Grafiku i praktikave spitalore te studenteve</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Në mënyrë që çdo student të kryejë realizimin e praktikës profesionale UAMD ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme private dhe publike të cilët u garantojnë dhe ofrojnë mjediset e tyre studentëve për plotësimin e kërkesave të moduleve dhe asimilimin e njohurive teorike dhe praktike nga studentët e këtij program studimi.</p> <p>Institucioni pritës ku zhvillohet praktika merr përsipër të asistojë dhe të monitorojë studentin që zhvillon praktikën nëpërmjet angazhimit të një punonjësi të tij, të krijojë kushte lehtësuese për zhvillimin e praktikës, si dhe në përfundim të hartojë një vlerësim me shkrim mbi punën, angazhimin dhe efektivitetin e praktikës profesionale, i cili merret në konsideratë për vlerësimin përfundimtar të praktikës profesionale.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.12 Rregullore e Sektorit te Komunikimit, Alumnit dhe Karrieres</i> <i>Nr.34 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD</i> <i>Nr.96 Tabela me Marrëveshjet e Bashkëpunimit të FSP</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Personeli akademik që angazhohet në këtë program studimi përmbush kërkesat ligjore në fuqi dhe ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për mësimdhënie në programin e studimit. Personeli akademik i Departamentit i angazhuar me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme rezulton të ketë qëndrueshmëri në këtë program studimi. Vihet re angazhim i personelit ndihmës i kualifikuar për realizimin dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve ndihmëse të procesit akademik. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit sipas kërkesave ligjore në fuqi.</i></p> <p><i>Zyra e Karrierës ka nënshkruar me përfaqësues të institucioneve private dhe publike me qëllim garantimin e një infrastrukture komode dhe finalizimin e suksesshëm të praktikës profesionale të studentëve të këtij program studimi. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin mbështetës të RVB si dhe vizitës së zhvilluar në Institucion, vihet re se UAMD siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore si dhe garanton infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve që ofron.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi ambiente të mjaftueshme të cilët janë të pajisur me mjetet dhe pajisjet e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor.</p> <ul style="list-style-type: none"> • 16 salla leksioni • 2 salla për aktivitete promovuese • 1 sallë për praktikë profesionale • 11 laboratorë për lendët • 1 laborator informatike • 1 sallë biblioteke • 1 zyrë informacioni për studentët • 22 mjedise për stafin si: zyra për stafin drejtues, personelin akademik dhe ndihmës akademik, dhe • ambiente të tjera shërbimi në funksion të procesit mësimor dhe punës kërkimore shkencore. <p>Studentët kanë aksesin në të gjitha ambientet e nevojshme për zhvillimin e një procesi mësimor me kushte moderne. Sallat e leksioneve, biblioteka, labororet me teknologji moderne, janë më se të përshtatshme për zhvillimin e metodave aktuale të mësimdhënies.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.42 Planimetria Currila + Kampus</i></p> <p><i>Nr.42.1 Infrastruktura Currila+Kampus 2019</i></p> <p><i>Nr.51 Biblioteka Online (manual)</i></p> <p><i>Nr.52 Biblioteka Online te dhena mbi materialet e disponueshme</i></p>

	<p>Nr.53 "Digital Library" - UAMD Nr.54 Lista e paketave U-Library Nr.69 Te dhena te plota per Infrastrukturen e FSP dhe ne funksion te programit te studimit 2022 74 - Tabelat ASCAL dega bachelor Infermieri e pergjithshme</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mesimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mesimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mesimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Në takimet me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi se ambientet ku zhvillohet mësimi plotësojnë kërkesat e sipërfaqes së shfrytëzueshme sipas kuadrit rregullator në fuqi. GVJ vizitoi disa salla leksionesh dhe laboratorët, sallën për aktivitete promovuese si konferenca, bibliotekën, zyrat dhe mjedise të tjera në shërbim të procesit mesimor dhe vuri re që mjediset mesimore ishin të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit si PC, projektorë të lëvizshëm, dhe sistem audio si dhe kanë ndriçim optimal të cilat mundësojnë përdorimin e teknologjisë bashkëkohore mesimore si nga stafi akademik edhe nga studentët.</p> <p>Evidenca:</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Nr.42 Planimetria Currila + Kampus Nr.42.1 Infrastruktura Currila+Kampus 2019 Nr.51 Biblioteka Online (manual) Nr.52 Biblioteka Online te dhena mbi materialet e disponueshme Nr.53 "Digital Library" - UAMD Nr.54 Lista e paketave U-Library Nr.69 Te dhena te plota per Infrastrukturen e FSP dhe ne funksion te programit te studimit 2022 74 - Tabelat ASCAL dega bachelor Infermieri e pergjithshme</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>UAMD ofron laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme për të shërbyer programit të studimit. Laboratorët janë të pajisur me programe profesionale në mbështetje të kurrikulës së programit që përdoren nga studentët në aktivitetin e tyre kërkimor dhe shkencor.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Nr.13. Rregullore e sektorit të teknologjisë së informacionit Nr.69 Te dhena te plota per Infrastrukturën e FSP dhe ne funksion te programit te studimit 2022</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>UAMD siguron ambiente të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive mesimore. Ambientet mesimore</p>

	<i>dhe mjediset e tjera ndihmëse janë të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve, GVJ konstaton literatura bazë dhe literatura e rekomanduar ofrohet për studentët në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj. Kjo literaturë gjendet në formë fizike dhe/ose digjitale pranë bibliotekës së universitetit. Përveç literaturës së cituar në syllabuset e lëndëve, gjatë vizitës në institucion, GVJ l'u konfirmua se pedagogët vënë në dispozicion të studentëve përmbledhje me slide apo ushtrime dhe raste studimore për lëndët përkatëse. Kjo literaturë plotëson të gjitha kriteret për të dhënë njohuritë e kërkuara për këtë program studimi.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.51 Biblioteka Online (manual)</i> <i>Nr.52 Biblioteka Online te dhena mbi materialet e disponueshme</i> <i>Nr.53 "Digital Library" - UAMD</i> <i>Nr.54 Lista e paketave U-Library</i> <i>Nr.123 Syllabuset Infermieri e pergjithshme v.a. 2019-2020.pdf</i> <i>Nr.124 Syllabuset Infermieri e pergjithshme v.a. 2020-2021.pdf</i> <i>Nr.124.1 Syllabuset Infermieri e pergjithshme v.a. 2021-2022.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Drejtuesi i Departamentit përgjegjës për këtë program studimi planifikon së bashku me stafin, nevojën për tituj librash. Sipas RVB, por edhe gjatë vizitës, drejtuesit e institucionit u shprehën se angazhohen në përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>




	<p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.47 Rregullorja e Bibliotekes.pdf</i> <i>Nr.48 Informacione per biblioteken UAMD.pdf</i> <i>Nr.49 Lista e Teksteve në Bibliotekën e UAMD.pdf</i> <i>Nr.50 Lista e Teksteve në Bibliotekë për Programin e Studimit.pdf</i> <i>Nr.51 Biblioteka Online (manual).pdf</i> <i>Nr.52 Biblioteka Online te dhena mbi materialet e disponueshme.pdf</i> <i>Nr.53 "Digital Library" - UAMD.pdf</i> <i>Nr.54 Lista e paketave U-Library.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>UAMD vë në dispozicion bibliotekën e cila është e aksesueshme në mënyrë të barabartë nga të gjithë studentët. Studentët e programit të studimit kanë në dispozicion bibliotekën shkencore të UAMD. Biblioteka ushtron aktivitetin e saj në bazë të rregullores në lidhje me regjistrimin e materialeve bibliotekare, sigurimin e informacionit për përdoruesit nëpërmjet skedareve, krijimin dhe mirëmbajtjen e katalogut online dhe arkives digjitale, pasurimit nëpërmjet blerjeve, dhuratave, projekteve dhe shkëmbimit, vënies në shërbim të lexuesve koleksionet e bibliotekës në sallat e leximit ose huazimit të tyre, plotësimin të kërkesave të lexuesve, ku janë depozituar edhe tekset dhe materialet mësimore të programit të studimit etj.</p> <p>Rregullorja përcakton dhe të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të bibliotekës duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. Studentët kanë mundësi të punojnë në bibliotekë ose të marrin materialet, kundrejt anëtarësimit me kartelë identifikimi dhe pa pagesë.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.47 Rregullorja e Bibliotekes.pdf</i> <i>Nr.48 Informacione per biblioteken UAMD.pdf</i> <i>Nr.51 Biblioteka Online (manual).pdf</i> <i>Nr.52 Biblioteka Online te dhena mbi materialet e disponueshme.pdf</i> <i>Nr.53 "Digital Library" - UAMD.pdf</i> <i>Nr.54 Lista e paketave U-Library.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën</p>	<p>Gjatë takimit me studentët e këtij programi, GVJ konstatoi se ata kanë mundësi të përdorin si literaturën fizike dhe online në bibliotekë në mënyrë të barabartë me qëllim përmbushjen e mjaftueshme të njohurive për mbarëvajtjen e këtij programi. Nga vizita në bibliotekë, si dhe</p>




<p>shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>informacioni paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, rezultoi se biblioteka disponon literaturë fizike të nevojshme në mbështetje të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera të UAMD si: tekste mësimore bazë në gjuhën shqipe; tekste mësimore dhe materiale ndihmëse në gjuhë të huaj; libra, periodikë, monografi, revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.48 Informacione per biblioteken UAMD.pdf</i> <i>Nr.51 Biblioteka Online (manual).pdf</i> <i>Nr.52 Biblioteka Online te dhena mbi materialet e disponueshme.pdf</i> <i>Nr.53 "Digital Library" - UAMD.pdf</i> <i>Nr.54 Lista e paketave U-Library.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion dhe takimit të zhvilluar me studentët se përveç literaturës fizike që gjendet në ambientet e bibliotekave, studentët kanë mundësi të përdorin pa pagesë edhe bibliotekat online të ofruara nga institucioni. Institucioni ka vënë në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve disa platforma online si: u-Library, Cobiss, Koha Jstore etj. ku ata kanë akses në literaturë në gjuhë shqipe dhe në gjuhë të huaj. Studentët dhe stafi akademik mund të huazojnë materiale me anë të kartave të tyre të identitetit dhe kartës së studentit, dhe pa pagesë.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.47 Rregullorja e Bibliotekes.pdf</i> <i>Nr.48 Informacione per biblioteken UAMD.pdf</i> <i>Nr.51 Biblioteka Online (manual).pdf</i> <i>Nr.52 Biblioteka Online te dhena mbi materialet e disponueshme.pdf</i> <i>Nr.53 "Digital Library" - UAMD.pdf</i> <i>Nr.54 Lista e paketave U-Library.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Sipas dokumentacionit shoqërues të RVB dhe vizitë në Institucion biblioteka universitare u konstatua se zona e Kompjuterave ndodhet brenda ambienteve të bibliotekës dhe secili kompjuter është i lidhur në rrjet në dispozicion për studentët. E gjithë zona e bibliotekës është e mbuluar me lidhje ëireless. Kompjuterat në ambientin e bibliotekës kanë të instaluar programe që u mundësojnë studentëve aksesin në bibliotekën elektronike. Gjatë vizitës në institucion GVJ iu konfirmua se biblioteka frekuentohej</p>




	<p>vazhdimisht nga studentët jo vetëm për të tërhequr libra apo materiale mësimore por edhe si sallë studimi/leximi.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.48 Informacione per biblioteken UAMD.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka e Universitetit me bibliotekare eksperte operon çdo ditë të javës dhe orari i shërbimit është i përshtatur me orarin e zhvillimit të procesit mësimor në UAMD. Përveç ditëve të javës, institucioni ka marrë masa që biblioteka të jetë e hapur për studentët edhe gjatë fundjavës.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.48 Informacione per biblioteken UAMD.pdf</i> <i>Nr.55 Kalendari bibliotekes ne fundjave.pdf</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në UAMD, GVJ vlerëson se institucioni angazhohet në mënyrë aktive lidhur me cilësinë e fondit fizik të bibliotekës, përditësimin dhe shkallën e shfrytëzimit të saj me tituj të rinj në mbështetje të të gjithë programeve të studimit. Përditësimi i bibliotekës bëhet në bazë të rekomandimeve të stafit, duke u rritur cilësia e fondit fizik të bibliotekës dhe asaj online.</p> <p>Megjithatë është i nevojshëm angazhimi më shumë i stafit në përditësimin e vazhdueshëm dhe hartimi i teksteve mësimore të viteve të fundit dhe ti bëjë ato pjesë të bibliotekës së institucionit.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.48 Informacione per biblioteken UAMD.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Literatura bazë dhe ndihmëse në përmbushin objektivat e tij tstudimit dhe u mundësojnë studentëve të marrin njohuritë e nevojshme të parashikuara në program. Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik bibliotekën me tituj fizikë dhe disa platforma online, duke mundësuar akses dhe shfrytëzim optimal të literaturës së ofruar për studentët dhe për stafin akademik. Megjithatë është i nevojshëm angazhimi më shumë i stafit në përditësimin e vazhdueshëm dhe hartimi i teksteve</i></p>

	<i>mësimore të viteve të fundit dhe ti bëjë ato pjesë të bibliotekës së institucionit. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB-se dhe vizitës në institucion, UAMD ka në përdorim një sistem të menaxhimit të informacionit (Pitagora) në lidhje me studentët, të dhënat e tyre personale, të dhënat akademike si dhe plan programet në të cilët studentët janë të regjistruar. Administrimi i informacioni lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre menaxhohet gjithashtu nëpërmjet strukturave të ngritura në organikën e UAMD. Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike, dhe Sekretaria e Fakultetit, si edhe zyra të tjera që bëjnë administrimin e informacionit, të cilat funksionojnë në bazë të rregulloreve përkatëse.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 18 Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i></p> <p><i>Nr.32 Sistemi PITAGORA (RASH).pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion u konstatua se pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Juridike dhe Departamenti, përgjegjës për programin e studimit. Administrimi i informacionit dhe dokumentacionit të personelit akademik, personelit ndihmës-akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit realizohet nga Sektori i Burimeve Njerëzore, si është një strukturë në varësi të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Juridike, sipas rregullores përkatëse (neni 7) përgjigjet për plotësimin e dosjes personale me dokumentacionin e nevojshëm për çdo punonjës të institucionit dhe mban (në kartotekë) dokumentacionin e plotë dhe të rregullt të tij.</p> <p>Dokumentacioni kërkimor dhe shkencor lidhur me personelin akademik administrohet dhe përditësohet nga departamenti.</p>




<p>personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të informacionit menaxhohet nga zyrat përkatëse dhe siguron akses të dedikuar për të gjithë përdoruesit e tij. Informacioni është i disponueshëm për të gjithë personelin dhe studentët në forma të ndryshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në rrugë elektronike nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të institucionit, nëpërmjet sistemit Pitagora ku studentët mund të logohen me anë të një user name personal dhe passëordi dhe të marrin informacion mbi vlerësimin e vazhdueshëm dhe përfundimtar të çdo lënë, si dhe nëpërmjet websitet personal (klasën virtuale) të çdo pedagogu ku mund të konsutojnë materialet lidhur me procesin mësimor. - Nëpërmjet zyrave përkatëse të institucionit përgjegjëse për administrimin dhe ruajtjen e informacionit, kundrejt miratimit nga institucioni të kërkesës të të interesuarve (personeli dhe studentët). <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 93_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p> <p><i>Nr. 18_Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i></p> <p><i>Nr.32 Sistemi PITAGORA (RASH).pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstatoi në takimet me stafin akademik dhe studentët se platforma Pitagora, garanton akses të dedikuar për të gjithë përdoruesit dhe me funksionalitetet e nevojshme të komunikimit për aspektet mësimore të ciklit akademik të studimeve pranë UAMD. Nëpërmjet kësaj platforme studentët kanë mundësi të aksesojnë në distancë çdo informacion lidhur me frekuentimin dhe vlerësimin në çdo lëndë të programit të studimit.</p> <p>Për procesin e mësimdhënies dhe mësimnxësis, personeli akademik përdor edhe platformat online Google Classroom dhe Teams. Kjo platformë është përdorur jo vetëm për të zhvilluar mësimin gjatë periudhës së zhvillimit të mësimin on-line, por përdoret aktualisht nga personeli akademik për të komunikuar me studentët dhe për të shkëmbyer informacion mbi lëndët, dhe materialet mësimore.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.32 Sistemi PITAGORA (RASH).pdf</i></p> <p><i>Nr.43.1 Pyetesor dhe relacion mbi mesimdhënien online.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të</p>	<p>Referuar RVB-Së, sistemi i menaxhimit (Pitagora) mundëson nxjerrjen e të dhënave të ndryshme që lidhen me studentët apo plan programet dhe përdoren nga zyrat përkatëse. Të</p>


<p>aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>dhënat që zakonisht gjenerohen nga sistemi i menaxhimit janë listat e notave të studentëve, lista e notave në bazë kursi, listë-prezencat për kurset respektive, të gjitha këto i përkasin ecurisë akademike. Nga ana tjetër, të dhënat e tjera që nxirren nga sistemi i menaxhimit kanë të bëjnë më raportime të ndryshme që Sekretaria mësimore ben si pjesë e punës së saj. Të dhënat janë kryesisht lista emërore të studentëve apo raportime statistikore. Aktet rregullatore të institucionit sigurojnë monitorimin e aktivitetit akademik e administrativ. Aktiviteti mësimor monitorohet nëpërmjet rregjistrimit mësimor i cili plotësohet dhe nënshkruhet nga pedagogu i lëndës. Në rast mungese bëhet njoftimi i drejtuesve në bazë të rregullores. Aktiviteti i sekretarisë mësimore mbikqyret nga Zv/dekalni për anën mësimore dhe realizohet në bazë të rregullores së fakultetit dhe rregullores së sekretarisë mësimore.</p> <p>GVJ gjykon se në tërësi sistemi i menaxhimit të UAMD bëhet në mënyrë të dokumentuar duke respektuar aktet rregullatore të institucionit dhe garanton monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit si dhe mundëson evidentimin në kohë të problematikave dhe marrjen e masave për përmirësim nga strukturat përkatëse.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 93 Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf.pdf</i> <i>Nr.08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale.pdf</i> <i>Nr.09 Rregullore e Departamentit të Shkencave Teknike Mjeksore.pdf</i> <i>Nr.10 Rregullore e programi te studimit Infermieri e pergjithshme.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Informacioni në faqen zyrtare të internetit të UAMD është i aksesueshëm në gjuhën shqipe, në gjuhën angleze dhe në gjuhën italiane. GVJ konstaton se institucioni publikon vazhdimisht informacion mbi aktivitete të ndryshme që lidhen me studentët.</p> <p><i>https://uamd.edu.al/fakulteti-i-studimeve-profesionale/</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka integruar disa platforma për administrimin e informacionit dhe dokumentacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre pranë UAMD. Sistemi i menaxhimit të informacionit i dokumentuar fizikisht siguron, nëpërmjet zbatimit të kuadrit rregullator të UAMD monitorimin në kohë</i></p>

	të aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit. Institucioni publikon në faqen e tij zyrtare të internetit informacion në gjuhën shqipe, angleze dhe italiane, por informacioni duhet të jetë më i përditësuar sikundër rezulton në rrjetet sociale të institucionit. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Bazuar në dokumentacionin shoqëruar të RVB dhe RVB deklarohet se institucioni kryen vlerësime financiare të kostove në nivel program nga departamenti. Megjithatë nga informacionin e marrë në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UAMD, GVJ konstatoi se institucioni harton raporte financiare në nivel institucional dhe jo të kostove të njësisë bazë sipas programeve apo cikleve të studimit, por vetëm në nivel fakulteti/universiteti. Kjo për shkak të specifikës së organizimit dhe funksionimit të institucioneve publike. Evidenca: <i>Nr. 62. Raporti financiar UAMD</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet	Sipas statutit, UAMD financohet nga buxheti i shtetit, pagesat e studentëve për arsim, të ardhurat për shërbimet e kryera, të ardhurat nga marrëdhëniet me palët e treta, donacione, verimtare kërkimore dhe projekte (neni 96). Të ardhurat e përfituara nga shërbimet, veprimtaritë kërkimore-shkencore, konferencat administrohen sipas një rregulloreje të veçantë, të propozuar nga Senati dhe të miratuar nga Bordi i Administrimit (neni 95 i Statutit). Sipas RVB buxhetet e miratuara nga çdo njësi bazë, kalojnë për miratim në njësinë kryesore dhe më pas në rektorat. Në vijim ky buxhet diskutohet dhe miratohet në mbledhjet e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. GVJ evidentoi dy dokumente të cilat përshkruajnë në mënyrë të përmbledhur planet e njësisë kryesore dhe bazë lidhur me




<p>financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>financimin dhe mbështetjen e personelit akademik. Megjithatë nuk identifikohen mekanizma/, akte rregullatore të fakultetit/departamentit që të parashikojnë hapat që ndiqen në hartimin e projekt buxhetit në mënyrë që të përfshihen të gjitha njësitë përbërëse të UAMD.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.63. Plani financiar vjetor i FSP</i></p> <p><i>Nr.68. Të dhëna për planin e financimit të programit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Bazuar në nenin nr. 102 të statutit të UAMD, kontrolli dhe auditimi i brendshëm në UAMD dhe në njësitë përbërëse të tij realizohet nga njësitë e auditimit të brendshëm, krijimi i të cilave bëhet me vendim të Bordit të Administrimit. Sipas RVB, UAMD kryen auditimin e brendshëm sipas procedurave ligjore.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.25 Raporti i Veprimtarise Audituese.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Sipas RVB në raportin vjetor të UAMD të prezantuar nga Rektori para Senatit, Bordit të Administrimit, stafit akademik dhe administrativ dhe studentëve, bëhet një analizë e gjendjes financiare të institucionit. Sipas RVB ky raport bëhet publik në faqen zyrtare të institucionit nën rubrikën “vendime”.</p> <p>Nga shqyrtimi i kësaj rubrike GVJ konstaton se të aksesueshëm janë vetëm vendimet e vitit 2023, ndërsa vendimet e mëparshme nuk janë të aksesueshme në faqen e internetit.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.25 Raporti i Veprimtarise Audituese.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin</p>	<p>UAMD është institucion buxhetor dhe funksionon sipas parimit të autonomisë financiare, në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Sipas kuadrit rregullator në fuqi, burimet e financimit të UAMD janë: buxheti i shtetit; pagesat e studentëve për arsimim; të ardhurat për shërbimet e kryera; të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta; donacione dhe burime të tjera ligjore financimi; si dhe të ardhurat nga veprimtari kërkimore shkencore. Fondet e buxhetit të shtetit në përputhje me udhëzimet e MFE shpërndahen në formë granti për politikatat e zhvillimit të UAMD, për mësimdhënien</p>




<p>eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>dhe për punën kërkimore-shkencore e veprimtaritë krijuese. Përdorimi i fondeve publike nga UAMD bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të akorduar.</p> <p>Referuar raporteve vjetore të hartuara nga institucioni, rezulton se për vitin akademik 2020-2021 të ardhurat totale kanë qenë 1.082.354.067 lekë, nga të cilat 83,4% kanë ardhur nga buxheti i shtetit, për vitin akademik 2021-2022 të ardhurat totale kanë qenë 1.076.144.918 lekë, nga të cilat 76% kanë ardhur nga buxheti i shtetit dhe për vitin akademik 2022-2023 të ardhurat totale kanë qenë 1.133.710.586 lekë, nga të cilat 82,4% kanë ardhur nga buxheti i shtetit.</p> <p>Nga ana tjetër, UAMD rezulton të jetë një nga institucionet e arsimit të lartë në vend me numrin më të madh të studentëve, duke siguruar në këtë mënyrë të ardhura shtesë për institucionin dhe garanton qëndrueshmërinë financiare afatgjatë të tij.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 74 Tabelat ASCAL dega bachelor Infermieri e pergjithshme.pdf</i></p> <p><i>Nr.25 Raporti i Veprimtarise Audituese.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD funksionon sipas parimit të autonomisë financiare, në zbatim të ligjit Nr. 80/2015. <u>GVJ rekomandon</u> plotësimin e kuadrit rregullator të institucionit mbi administrimin dhe alokimin e të ardhurave të veta. UAMD harton projekt buxhete në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në nivel fakulteti/universiteti, por <u>GVJ nuk konstaton</u> ndonjë raport/analizë financiare mbi realizimin e zërave buxhetorë. Institucioni duhet të mbështesë me më shumë fonde kërkimin shkencor dhe bibliotekën. Institucioni i nënshtrohet kontrollit dhe auditimit të brendshëm nga Njësia e Auditimit të Brendshëm në varësi të Bordit të Administrimit të UAMD. UAMD si institucion buxhetor, i financuar kryesisht nga të ardhurat publike, garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit. Në kuadrin e transparenës, UAMD duhet të publikojë periodikisht buxhetin e tij. <u>GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</u></i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>




Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UAMD harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statutin e UAMD dhe Rregulloret. Kushtet e pranimit, regjistrimit dhe matrikullimit të studentëve janë të përcaktuara, në statutin dhe rregulloren e universitetit ku specifikohen qartë politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve. Kushtet e pranimit, regjistrimit të studentëve, përgjegjësitë, detyrat dhe të drejtat e tyre gjatë ciklit akademik, kontrolli i dijeve, transferimi, pezullimi dhe rifillimi i programit të studimit dhe deri tek diplomimi përcaktohen në Kapitullin IX të statutit, dhe në Kreun III (Organizimi i studimeve) të rregullores së universitetit, si edhe në rregulloren e Fakulteti, rregulloren e departamentit dhe në mënyrë më të detajuar në rregulloren e programit të studimit. Kuotat e pranimit, miratohen nga Senati i UAMD, në përputhje me ligjin 80/2015. Lista e aplikantëve për programin e studimit merret nga U - Albania. Bazuar në aplikimet, shpallet lista e fituesve, e cila është dhe në portalin U -Albania. Çdo person i regjistruar merr numër matrikullimi për të fituar kredite akademike.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe në bazë të dokumentacionit të RVB, GVJ konstaton se pranimi në këtë program studimi është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të institucionit të arsimit të lartë ku ata aplikojnë. Gjatë viteve të studimit, krahas praktikës që është lëndë e detyruar sipas programit, organizohen dhe panairë të punës dhe studimit, me qëllim rritjen e mundësisë të studentëve për të vendosur kontakte me tregun e punës para diplomimit.</p>




	<p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 04_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.pdf</i></p> <p><i>Nr. 93_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p> <p><i>Nr.08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale.pdf</i></p> <p><i>Nr.09 Rregullore e Departamentite Shkencave Teknike Mjeksores.pdf</i></p> <p><i>Nr.10 Rregullore e programi te studimit Infermieri e pergjithshme.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>UAMD garanton lirinë akademike dhe siguron mundësi të barabarta, në përputhje me përcaktimet e ligjit 80/2015 dhe aktet nënligjore të tij. Barazia dhe të drejtat e kandidatëve dhe studentëve të programit të studimit garantojnë nëpërmjet akteve rregullatorë të institucionit dhe zbatohen në të njëjtën mënyrë për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Veprimtaria mësimore bazohet në merita akademike, duke përjashtuar diskriminimet e racës, fesë, gjinisë, prejardhjes kombëtare, orjentimit seksual, të origjinës, të gjendjes civile, të aftësive fizike dhe të çdo faktori tjetër. Kodi i etikës i UAMD, është në përputhje me ligjin 80/2015, ligjin 9970 datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore", ligji 110221 datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen ndaj diskriminimit", ligjit 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 04_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.pdf</i></p> <p><i>Nr. 93_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p> <p><i>Nr.08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale.pdf</i></p> <p><i>Nr.09 Rregullore e Departamentite Shkencave Teknike Mjeksores.pdf</i></p> <p><i>Nr.10 Rregullore e programi te studimit Infermieri e pergjithshme.pdf</i></p> <p><i>Nr.29 Kodi i etikës i UAMD.pdf</i></p>




<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e programit të studimit, çdo kandidat që ka përfunduar arsimin e mesëm me sukses dhe plotëson kriteret e notës mesatare të përcaktuar me VKM, mund të aplikojë në portalin U- Albania, për tu regjistruar në këtë program studimi, në përputhje me nenin 74 të ligjit 80/2015.GVJ konstaton se sikurse përcaktohet edhe në rregulloren e programit të studimit (neni 9), pranimi në programin e studimit është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të institucionit të arsimit të lartë ku ata aplikojnë.</p> <p>Kuotat dhe kriteret e pranimit për përzgjedhjen e kandidatëve fitues propozohen nga Departamenti, miratohen nga Dekani dhe i përcillen Senatit Akademik, i cili miraton propozimin dhe ka për detyrë t'ia përcjellë MAS-it dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore para fillimit të aplikimeve për pranime. Njësia kryesore ka për detyrë të bëjë publike kuotat dhe kriteret e përcaktuara nga departamentet për të gjitha programet e studimit që ofron. Si rregull, këto kritere nuk mund të ndryshohen deri në përfundim të procesit të pranimeve të reja. UAMD mund të vendosë edhe kritere shtesë pranimi për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilat shpallen publikisht përpara fillimit të aplikimeve. Kriteret shtesë vihen në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.10 Rregullore e programi te studimit Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme".pdf</i></p> <p><i>Nr.110 Kriteret e pranimit te studenteve dhe kuotat.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Programi i studimit, pranon studentë të transferuar, në përputhje me ligjin 80/2015 dhe në rregulloren e programit të studimit, kërkesa e studentëve për transferimin e krediteve rishikohet nga një komision në nivel departamenti dhe aprovohet nga Dekani i Fakultetit përkatës.</p> <p>Aktet rregullatore të UAMD dhe në veçanti rregullorja e programit të studimit përcakton qartë kriteret dhe procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, shkëmbimit të studentëve, pranimin e studentëve të huaj dhe të transferuar, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, frekuentimit të lëndëve dhe të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit. Një pjesë e tyre si për shembull kriteret e pranimit të programin e studimit, janë të publikuara edhe në faqen zyrtare të insitucionit, duke qenë të aksesueshme nga publiku.</p>

M. Meti

tu

	<p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale.pdf</i></p> <p><i>Nr.09 Rregullore e Departamentite Shkencave Teknike Mjekësore.pdf</i></p> <p><i>Nr.10 Rregullore e programi te studimit Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme".pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion, konstatuam se kriteret e aplikimit për programin e studimit, janë të disponueshme në faqen zyrtare të Universitetit.</p> <p>Informimi realizohet edhe në ambientet e UAMD, nëpërmjet afishimit të kriterëve në standat e universitetit. Pranimi bëhet në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe përzgjedhja e kandidatëve bëhet në bazë të notës mesatare sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale.pdf</i></p> <p><i>Nr.09 Rregullore e Departamentite Shkencave Teknike Mjekësore.pdf</i></p> <p><i>Nr.10 Rregullore e programi te studimit Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme".pdf</i></p> <p><i>Nr.110 Kriteret e pranimit te studenteve dhe kuotat.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin shoqëruar të RVB, GVJ konstaton se për këtë program studimi për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara, zbatohen të njëjtat kriteret si edhe për aplikantët e tjerë.</p> <p>Megjithatë, UAMD ka hartuar një rregullore të brendshme mbi "Trajtimin e studentëve më aftësi të kuafizuara në UAMD".</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.21 Rregullore studente me aftesi te kufizuar.pdf</i></p> <p><i>Nr.110 Kriteret e pranimit te studenteve dhe kuotat.pdf</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Për çdo vit akademik, programi i studimit ka vendosur kuota për studentët e huaj. Studentët e huaj duhet të bëjnë njehsimin e diplomës dhe të përmbushin kriteret ligjore të vendosura nga ligji 80/2015, si dhe përcaktimi i notës mesatare që është i vendosur me VKM.</p> <p>Në rregulloren e Fakultetit parashikon pranimin e shtetasve të huaj në programet e ciklit të parë të studimeve, pika 6, ç.</p>


	Evidenca: <i>Nr.05. Rregullore UAMD</i> <i>Nr.08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale.pdf</i> <i>Nr.110 Kriteret e pranimit te studenteve dhe kuotat.pdf</i>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Referuar RVB, institucioni bazohet në udhëzimet dhe vendimet e qeverisë për politikat e ndihmës/bursave për shtresa në nevojë. GVJ nuk konstaton që kjo politikë të përfshihet në aktet rregullatore të institucionit dhe programit të studimit dhe nuk ka ndonjë evidencë mbi akordimin e tyre.			
Konkluzione	<i>Kriteret e pranimit, transferimit të studimeve janë të përcaktuara qartë nëpërputhje me ligjin 80/2015 dhe publike për të gjithë të interesuarit. Politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve të programit të studimit, janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi dhe statutin e UAMD.</i> <i>GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	UAMD vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion gjendet në rregulloren e universitetit, Rregulloren e Fakultetit dhe në mënyrë më të detajuar në rregulloren e programit të studimit Studentët vihen në dijeni mbi këto kriteret dhe procedura edhe nga personeli akademik gjatë orës së parë të mësimit, kur bëhet prezantimi i lëndës. Evidenca:


	<p><i>Nr. 93_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p> <p><i>Nr.08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale.pdf</i></p> <p><i>Nr.09 Rregullore e Departamentite Shkencave Teknike Mjeksores.pdf</i></p> <p><i>Nr.10 Rregullore e programi te studimit Infermieri e pergjithshme.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në përputhje me dispozitat e nenit 89 të ligjit 80/2015, UAMD ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferim të studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda të njëjtit institucion apo institucione të ndryshme të arsimit të lartë. Sipas rregullores së programit të studimit procedurat për transferimin e studimeve kryhen në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe pranohen në fillim të çdo viti akademik, jo më vonë së fundi i javës së dytë të semestrit të parë. Njohja e krediteve të marra nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve në këtë program studimi, bëhet nga Departamenti përkatës, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në rregulloret e UAMD.</p> <p>Studenti mund të transferojë studimet, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda fakulteti apo nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, nëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ka grumbulluar, sipas formulës së pranimit në programin përkatës të studimit, sasi pikësh më të larta se pragu minimal i pikëve, që është arritur në programin e studimit të kërkuar në vitin përkatës; - ka fituar jo më pak se 30 kredite në programin përkatës të studimit, nga vjen; - plotëson kriteret specifike për transferimin e studimeve të përcaktuara nga Departamenti. <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 93_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p> <p><i>Nr.08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale.pdf</i></p> <p><i>Nr.09 Rregullore e Departamentite Shkencave Teknike Mjeksores.pdf</i></p> <p><i>Nr.10 Rregullore e programi te studimit Infermieri e pergjithshme.pdf</i></p>




<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Vlerësimi i dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit përcaktohen në rregulloren e Fakultetit dhe në rregulloren e programit të studimit dhe në syllabuset e çdo lënde.</p> <p>Studenti fiton të drejtën të hyjë në provimin e një lënde kur ka shlyer të gjitha detyrimet që lidhen me atë lëndë, të parashikuara për shlyerje në planin mësimor, si dhe kur nuk ka detyrime financiare ndaj Universitetit “Aleksandër Moisiu”. Në këtë program studimi për të vlerësuar njohuritë e studentit përdoret sistemi shqiptar i vlerësimit. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor të lëndës vlerësohet me një sistem pikëzimi 1000 pikësh, i cili konvertohet në notë në procesverbalin përfundimtar. Nga verifikimi i syllabuseve, GVJ konstaton se vlerësimi i dijeve të studentëve kryhet duke u bazuar në shumën e pikëve të grumbulluara gjatë zhvillimit të kursit (maksimalisht 1000 pikë) si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Detyra, projekte, ese – 10% të vlerësimit total; • Provim i ndërmjetëm – 40% të vlerësimit total; • Provimit përfundimtar - 50% të vlerësimit total. <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu konfirmua se studentët njihen me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve nga stafi akademik i cili bën prezantimin e lëndës gjatë orës së parë të procesit mësimor.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale.pdf</i></p> <p><i>Nr.10 Rregullore e programi te studimit Infermieri e pergjithshme.pdf</i></p> <p><i>Nr.123 Syllabuset Infermieri e pergjithshme v.a. 2019-2020.pdf</i></p> <p><i>Nr.124 Syllabuset Infermieri e pergjithshme v.a. 2020-2021.pdf</i></p> <p><i>Nr.124.1 Syllabuset Infermieri e pergjithshme v.a. 2021-2022.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit përcaktohen pothuajse në të gjitha aktet rregullatore të UAMD: rregullorja e universitetit rregullorja e Fakultetit dhe rregullorja e programit të studimit</p> <p>Studimet e ciklit të parë përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë me titullin Bachelor. Studenti nuk mund të mbrojë tezën e diplomës pa shlyer më parë të gjitha detyrimet dhe pa fituar numrin e krediteve të parashikuara në planet mësimore të programit përkatës të</p>




	<p>studimit. Rregulloren për projektin të diplomimit për studentët e ciklit bachelor, janë shpjeguar rregullat e projektit të diplomimit, si për shembull kontrolli për plagjaturë, ndekja e udhëzimeve të pedagogut drejtues për afatet e dërgimit të pjesëve të veçanta të punimit si dhe punës përfundimtare.</p> <p>Teza e diplomës është një punë e pavarur dhe krijuese e studentit në formën e një projekti apo studimi UAMD ka hartuar një rregullore për punimin e diplomës nëpërmjet të cilit studentët udhëzohen për hapat që duhet të ndjekë nga kërkesa për temën e diplomës pranë sekretarisë, zgjedhja e temës së diplomës, procedura për shkrimin e punimit të diplomës dhe prezantimi përpara komisionit të diplomës.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 93_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p> <p><i>Nr.08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Sipas RVB dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ i’u konfirmua se informimi i të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit bëhet nëpërmjet takimeve të hapura në auditorë dhe nëpërmjet publikimit të informacionit në faqen zyrtare të institucionit dhe në rrjetet sociale.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>https://www.uamd.edu.al</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD vë në dispozicion të studentëve informacionin e detajuar në Rregulloren e Departamentit, në Rregulloren e Programit të Studimit që janë të disponueshme online në faqen zyrtare të UAMD.</i></p> <p><i>UAMD vë në dispozicion të studentëve informacionin mbi kriteret e vlerësimit të dijeve në programin e studimit, përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës e cila i vihet në dispozicion studentëve në fillim të semestrit nga pedagogu i lëndës. Intitucioni organizon takime informuese dhe publikon informacione për palët e interesuara për programin e studimit. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>





				X
--	--	--	--	---

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Të gjitha informacionet për programet që ofrohen në UAMD, strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit janë të aksesueshme në faqen zyrtare të institucionit, rrjetet sociale, informacionit që marrin nga sekretaria mësimore që në momentin e aplikimit apo regjistrimit dhe vënia në dispozicion e dosjes së programit të studimit, si dhe nga stafi akademik gjatë javës së parë të fillimit të vitit akademik.</p> <p>Evidenca:</p> <p>https://www.uamd.edu.al</p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Nga vizita në institucion, takimi me studentët, konstatoam se ata ishin të mirë informuar për të gjitha aspektet e procesit mësimor. Krahas Rregullores së programit të studimit që ka informacione të detajuara për kursin, dokument që është në dispozicion të studentëve dhe i aksesueshëm online, studentët e marrin informacionin nga instruktori i lëndës në ditën e parë të mësimimit duke u prezantuar edhe me syllabusin përkatës. Studentët e programit të studimit kanë mundësi të marrin informacion lidhur me modulet dhe përmbajtjen e programeve të studimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përmes faqes zyrtare online të institucionit dhe rrjeteve sociale; - përmes informimit nga zyra e sekretarisë; - përmes prezantimit nga stafi akademik të syllabuseve të lëndëve mësimore, gjatë orës së parë të mësimimit ku marrin informacione të detajuara mbi objektivat e lëndës, aftësitë dhe kompetencat e synuara, ngarkesën mësimore, temat për çdo javë mësimore, format e kontrollit dhe vlerësimit, kërkesat për frekuentimit të lëndës, si dhe literaturën bazë dhe të rekomanduar; - përmes afishimeve në mjediset e UAMD.

	<p>Evidenca:</p> <p>https://www.uamd.edu.al</p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Fakulteti në bashkëpunim me Zyrën e Alumni dhe Karrierës ka nënshkruar bashkëpunime me institucione të ndryshme të sektorit publik dhe privat. Zyra e Alumni dhe Karrierës dhe Departamenti përgjegjës mbështet studentët në orientimin e tyre drejt tregut të punës duke organizuar vazhdimisht takime me drejtues të institucioneve të ndryshme në vend, në bazë të marrëveshjeve që UAMD ka lidhur me biznese dhe institucione publike për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve, të cilat ndihmojnë për një qasje sa më të mirë të studentëve me tregun e punës.</p> <p>Studentët e programit të studimit, realizojnë “internship” pranë këtyre institucione nga ku kanë mundësi dhe për punësim pas mbylljes së detyrimeve akademike.</p> <p>Zyra e Alumni dhe Karrierës ka gjithashtu për detyrë informimin dhe këshillimin e studentëve lidhur me mundësitë e punësimit dhe karrierën e tyre dhe mundëson pjesëmarrjen e studentëve në panairin e punës dhe karrierës të organizuar nga UAMD.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.133 Grafiku i praktikave spitalore te studenteve.pdf</i></p> <p><i>Nr.34 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD.pdf</i></p> <p><i>Nr.86 Model Pyetësori për Studentet e Diplomuar.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët, u konfirmua se gjatë javës së parë të fillimit të vitit akademik, studentët informohen mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Ky informacion mund të sigurohet nëpërmjet stendave dhe sinjalistikës orientuese brenda ambienteve të fakultetit si edhe nga publikimi i informacionit online në web si dhe në rrjete sociale.</p> <p>Evidenca:</p> <p>https://www.uamd.edu.al</p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm</p>	<p>Krahas informacionit që është i aksesueshëm në faqen zyrtare të UAMD për programin e studimit, studentët progresin akademik të tyre mund ta ndjekin në platformën Pitagora, platformë funksionale online për të gjithë studentët e rregjitruar. Gjithashtu studentët kanë mundësinë e takimeve</p>




të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	të drejtpërdrejta me drejtuesin e departamentit, koordinatorin e programit të studimit dhe sekretarinë mësimore. Evidenca: https://www.uamd.edu.al <i>Nr.32 Sistemi PITAGORA (RASH).pdf</i>								
Konkluzione	<i>Informacioni për programin e studimit dhe aktivitetet që zhvillohen në funksion të mësimdhënies janë të detajuara. Sistemi i menaxhimit të informacionit është funksional dhe lehtësisht i aksesueshëm në çdo kohë nga studentët dhe personeli akademik dhe administrativ. UAMD informon studentët mbi logjistikën, infrastrukturën e institucionit, strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Informimi realizohet përmes takimeve, vënies në dispozicion të studentëve të dosjes të programit të studimit, si dhe publikimit të informacionit në ambientet e institucionit dhe në faqen zyrtare të internetit. Institucioni, nëpërmjet strukturave që ka ngritur, informon studentët mbi mundësitë e punësimit të tyre dhe zhvillon aktivitete në bashkëpunim me institucione dhe biznese për orientimin e tyre drejt tregut të punës. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						


Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>UAMD në organigramën e tij ka ngritur Drejtorinë e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike, e cila ushtron veprimtarinë në bazë të rregullores së saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kuadrin rregullator të UAMD. Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike disponon dhe ruan të dhëna për progresin akademik të studentëve aktual, sipas lëndëve, profileve të studimit dhe vitit akademik ku ata janë të regjistruar</p> <p>Në mënyrë më specifike (neni 17), Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, pjesë e kësaj drejtorie mbledh databazat e studentëve aktualë dhe studentëve të diplomuar nga kryesekretaret e secilit fakultet, kryen përpunimin</p>

	<p>statistikor të tyre dhe përditësimin e të dhënave, hartimin e tabelave statistikore mbi numrin e studentëve me bursë dhe atyre me ndihmë ekonomike, përpunimin e të dhënave statistikore mbi studentët inaktivë dhe të çrregjistruar, hartimin e tabelave statistikore për çdo vit të ri akademik mbi realizimin e kuotave, aplikimet dhe rregjistrimet e studentëve të vitit të parë dhe notën mesatare në hyrje etj.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.18 Rregullore Drejtori e admin. e shërbime akademike.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga vizita pranë sekretarisë të institucionit, si dhe dokumentacioni i dorëzuar, konkludojmë se institucioni mban të dhëna të sakta të numrit të studentëve studentëve të regjistruar, larguar, transferuar dhe diplomuar sipas programeve dhe cikleve të studimit. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore GVJ u konsultua me regjistrin themeltar dhe me regjistrin e arritjeve akademike. GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet personale dhe të ecurisë akademike të dy studentëve të programit të studimit dhe konstatoi plotësinë e tyre.</p> <p>Për këtë program studimi, GVJ konstatoi që numri i studentëve të regjistruar gjatë tre viteve të fundit akademike të raportuar në RVB përputhej me numrin e studentëve në regjistrin themeltar të plotësuar nga sekretaria mësimore.</p> <p>Në programin e studimit Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme" cikli i parë i studimeve janë regjistruar 115 në vitin akademik 2019-2020, 154 studentë në vitin akademik 2020-2021 dhe 137 studentë në vitin akademik 2021-2022.</p> <p>Studentë të çrregjistruar për vitin akademik 2019- 2020 janë 6, për vitin akademik 2020-2021, 6 studentë dhe për vitin akademik 2021-2022 9 studentë.</p> <p>Janë diplomuar 96 studentë në 2019-2020, 81 studentë në vitin 2020- 2021 dhe 89 në vitin akademik 2021-2022.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 74 Tabelat ASCAL dega Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme".pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të</p>	<p>Të dhënat për lëndët, mungesat, detyrat dhe projektet, pikët e provimit përfundimtar dhe të ndërmjetëm, janë të hedhura online në platformën Pitagora, e cila është e aksesueshme dhe nga stafi dhe nga studentët. Të gjitha të dhënat statistikore të</p>

<p>brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>studentëve (numri i matrikullimit, nota mesatare në hyrje dhe në dalje, vlerësimi i arritjeve të studentëve dhe të dhëna të tjera personale) ruhen dhe menaxhohen në sistemin e brendshëm të informacionit në format elektronik dhe në formë të dokumentuar nga sekretaria mësimore dhe Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike, e cila i vë në dispozicion të personave të autorizuar.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 18_Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i></p> <p><i>Nr.32 Sistemi PITAGORA (RASH).pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Sipas RVB kontrolli i njësive përgjegjëse për menaxhimin e informacionit (Sekretaria Mësimore dhe Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike) e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në bazë të rregulloreve përkatëse dhe kuadrit rregullator në fuqi. Duke i'u referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe rregulloreve përkatëse Fakulteti dhe Departamenti si njësitë përgjegjëse të programit të studimit, kanë për detyrë të dokumentojnë dhe vlerësojnë saktësinë e informacionit dhe dokumentacionit që lidhet me studentët.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 93_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p> <p><i>Nr.08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale.pdf</i></p> <p><i>Nr.09 Rregullore e Departamentite Shkencave Teknike Mjeksore.pdf</i></p> <p><i>Nr.10 Rregullore e programi te studimit Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme".pdf</i></p> <p><i>Nr. 18_Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Departamenti ofrues i programit të studimit, ka të dhëna periodike për ecurinë akademike të studentëve pas çdo semestri. Duke filluar që nga regjistrimi i studentëve, nota mesatare në hyrje, dhe progresi akademik për çdo semestër. Duke i'u referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Departamenti analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve (statistika bazuar në notën mesatare). Ky informacion është pjesë e analizës së veprimtarisë së departamentit për vitin akademik, e cila mbyllet me</p>

	<p>problematikat dhe shoqërohet me rekomandime për përmirësime.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.70. Analiza vjetore e FSP 2020- 2021.pdf</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Të dhënat për programin e studimit janë të plota, të ruajtura konform ligjit 80/2015 dhe ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Në sekretarinë mësimore janë mirëmbajtur, ruajtur dhe hedhur të dhënat e studentëve të programit të studimit, në regjistrin themeltar, regjistrin e notave dhe procesverbalë të provimeve. Sistemi i brendshëm i informacionit i UAMD mundëson kontrollin e të dhënave nga personat e autorizuar dhe ruajtja jep siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.</i></p> <p><i>Për vlerësimin dhe dokumentimin e saktësisë së informacionit që disponojnë njësitë përgjegjëse të menaxhimit të brendshëm të informacionit, UAMD bazohet në aktet rregullatore ku përcaktohet detyrat dhe përgjegjësitë e secilit. Departamenti në bashkëpunim me Drjetorinë e Shërbimeve Studentore dhe Akademike analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre</p>	<p>Rregullorja e UAMD (neni 115) përcakton të drejtën e studentëve për tu përfaqësuar në organet e UAMD dhe për të marrë pjesë në të gjitha proceset e vendimarrjes, në përputhje me parashikimet ligjore dhe statutore. Këshillat studentore janë organizime të pavaruara dhe mbrojnë interesat e studentëve të UAMD dhe specifiki të studentëve në programin e studimit.</p>

<p>regullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Evidenca: <i>Nr.04 Statuti i UAMD.pdf</i> <i>Nr. 93_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nga dokumentacioni i dorëzuar dhe vizata në institucion, konstatuam se, studentët përfaqësohen në Senatin Akadmiq, Bordin e Administrimit (lajmërim për zgjedhjen e anëtarit të BA) dhe Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (tabela nr. 24).Megjithatë GVJ konstaton se përveç informimit të studentëve, nuk u identifikuan aksione/veprimtari të studentëve apo të institucionit që kanë si pikënisje shqetësimet apo projektet studentore.</p> <p>Evidenca: <i>Nr. 74 Tabelat ASCAL dega bachelor Infermieri e pergjithshme.pdf</i> <i>Nr.89 Komisionet me përbërje të studentëve.pdf</i> <i>Nr.142 Rregullore e zgjedhjeve te studentëve në Këshillat studentorë”.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Për çdo semestër shpëndahen formularë vlerësimi që plotësohen nga studentët, para fillimit të sezonit të provimeve. Rezultatet e pyetësorëve shpallen pas përfundimit të sezonit të provimeve, me qëllim që të mos ketë mundësi për ndikim në vlerësim. Përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta realizohet nëpërmjet këtyre pyetësorëve ku studentët mund të komentojnë dhe japin sugjerime mbi lëndët dhe programet e studimit që ata ndjekin. Rezultatet e pyetësorëve janë objekt diskutimi dhe bëhen pjesë e analizës vjetore dhe planit të masave për përmirësim që ndërmerren duke filluar që nga departamenti.</p> <p>Evidenca: <i>Nr.106 Formular tip vleresim stafi nga studentet.pdf</i> <i>Nr.107 Anketimi i studenteve.pdf</i> <i>Nr.107.1 Rezultate anketimi.pdf</i> <i>Nr.108 Transparenca e Rezultateve te Anketimeve te Studenteve.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe</p>	<p>Në rregulloren e Fakultetit, parashikohet e drejta e studentit për të ankimuar rezultatin e provimit duke adresuar kërkesën e tij pranë drejtuesit të njësisë kryesore ku bën pjesë studenti jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve. Drejtuesi i njësisë kryesore kur e sheh të</p>

<p>kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>arsyeshme i kalon për shqyrtim kërkesën drejtuesit të departamentit përkatës. Drejtuesi i departamentit, i cili vë në dijeni dhe personelin akademik të lëndës pas shqyrtimit të kërkesës dërgon te drejtuesi i njësisë kryesore një relacion shpjegues. Në bazë të relacionit drejtuesi i njësisë kryesore vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës së studentit. Në rastin kur kërkesa miratohet, Dekani ngre një komision ad-hoc për rishikimin e tezës. Rregullorja parashikon edhe afatet kur ngrihet komisioni dhe kur studenti merr përgjigjen përfundimtare të vlerësimit të tij.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale.pdf</i></p> <p><i>Nr.109 Kerkese studenti per rishikim provimi, permiresim rezultati.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD ka mundësuar angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik, në NJSBC si edhe pranë Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të këtij programi studimi, si dhe organizimin e tyre në Këshilla Studentorë. Opinionet dhe mendimet e studentëve merren edhe nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të cilësisë, si pyetësorët, nëpërmjet të cilit studentët bëjnë vlerësimin e procesit akademik dhe personelit pedagogjik sipas lëndëve, programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. Rregullorja e Fakulteti, parashikon të drejtën e ankimimit për të gjithë studentët lidhur me procesin e kontrollit të dijeve dhe vlerësimin në provim. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.6</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të</p>	<p>UAMD ka ngritur njësi të posaçme në shërbim të studentëve si Sekretaria Mësimore, Zyra e Financës, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike, të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në</p>




<p>studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>bazë të rregulloreve përkatëse dhe në përputhje me statutin dhe aktet rregullatore të institucionit.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 18_Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i></p> <p><i>Nr.11 Rregullore Sistemi brend sigurimi cilesise (NJBSC).pdf</i></p> <p><i>Nr.12 Rregullore e Sektorit te Komunikimit, Alumnit dhe Karrieres.pdf</i></p> <p><i>Nr.33.1 Organograma e UAMD, Programet UAMD.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Të gjitha zyrat e UAMD janë në shërbim dhe në funksion të studentëve, por Sekretaria Mësimore dhe Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike informojnë dhe mbështesin studentët vazhdimisht gjatë ciklit të studimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sekretaria mësimore e ngritur në nivel njësie kryesore, ka si mision të saj funksionim, organizimin dhe shërbimin ndaj studentëve dhe stafit akademik. - Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike, spcifikisht Zyra e Alumni dhe Karrierës, asiston dhe këshillon studentët që të bëjnë lidhjen më të mirë mes përvojës së tyre akademike dhe udhëve të karrierës që do të ndjekin. - Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë informon studentët në lidhje me akreditimin e programit. - Gjithashtu edhe Departamenti i Financë Kontabilitetit si njësia bazë përgjegjëse e programit të studimit është në shërbim të studentëve për çdo informacion që lidhet me veprimtarinë mësimore të tyre. <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.11 Rregullore Sistemi brend sigurimi cilesise (NJBSC).pdf</i></p> <p><i>Nr.12 Rregullore e Sektorit te Komunikimit, Alumnit dhe Karrieres.pdf</i></p> <p><i>Nr. 18_Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe</p>	<p>UAMD ka ngritur Sektorin e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, pjesë e strukturës së Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike, e cila ka për qëllim ndërtimin e marrëdhënieve me studentë aktual, Alumni, punëdhënës dhe institucione për të lehtësuar praktika studentore, punësim dhe mundësi karriere.</p>

<p>periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Ky sektor midis detyrave të tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ofron këshillim dhe udhëzime në lidhje me orientimin dhe zhvillimin e karrierës profesionale të studentëve në UAMD. - organizon dhe koordinon aktivitetet për studentët të tilla si: trajnime, seminare, konferenca studentore, orë leksioni të hapura nga lektorë të ftuar, promovim të aftësive të studentëve si në letërsi, pikturë etj. - mban kontakte dhe grumbullon informacione mbi punësimin e Alumnit. - harton Guidën Studentore, Materialet udhëzuese për maturantët. - harton dhe raporton në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të dhëna statistikore mbi numrin e studentëve aktualë, studentëve të diplomuar etj. <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.12 Rregullore e Sektorit te Komunikimit, Alumnit dhe Karrieres.pdf</i></p> <p><i>Nr. 18_Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i></p> <p><i>Nr.34 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD.pdf</i></p> <p><i>Nr.39 Shoqata Alumni UAMD.pdf</i></p> <p><i>Nr. 88 Tabela 23 - Punesimi i studenteve.pdf</i></p> <p><i>Nr.136 Ceppus Agreement intership.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës ndjek studentët e diplomuar në tregun e punës. Kjo zyrë është përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave për të diplomuarit mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit, ndjek integrimin e tyre në tregun e punës dhe mban kontakte me studentët e diplomuar me qëllim bashkëpunimin për interesa të përbashkëta. Zyra e Alumnit dhe Karrierës përgatit raporte statistikore lidhur me përqindjen e studentëve të punësuar në çdo program studimi.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 18_Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i></p> <p><i>Nr.34 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD.pdf</i></p> <p><i>Nr.39 Shoqata Alumni UAMD.pdf</i></p> <p><i>Nr. 88 Tabela 23 - Punesimi i studenteve.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD ka ngritur disa struktura si Sekretaria Mësimore, Zyra e Financës, Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike etj të cilat mbajnë kontakte të vazhdueshme me studentët për t'i informuar për mundësi të ndryshme që ata</i></p>


	<i>kanë, por dhe për të zgjidhur probleme që mund të hasin gjatë studimit. Shërbimi i këshillimit të karrierës ofrohet kryesisht nga Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës e cila ofron informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale dhe orientimin në tregun e punës. Zyra e Alumnit Karrierës ndjek studentët pas diplomimit dhe harton raporte statistikore me të dhëna mbi shkallën e cilësisë së punësimit të studentëve. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Në bazë të dokumentacionit shoqëruar, RVB-së, dhe nga takimet gjatë vizitës në UAMD GVJ konstaton se institucioni angazhohet vazhdimisht në zhvillimin e mekanizmave dhe metodave inovative të mësimdhënies në ndihmë të procesit mësimor. Plani strategjik përcakton si një objektiv të rëndësishëm nxitjen dhe favorizimin e metodologjive të reja dhe mësimdhënien inovative, që e pozicionojnë studentin në qendër të procesit duke inkurajuar të menduarin kritik, përgatitjen për tregun e punës dhe promovimin e dialogut student-pedagog. Puna mësimore brenda këtij programi studimi zhvillohet konform formave të mësimimit dhe të kontrollit të dijeve të përshkruara në rregulloret e brendshme të UAMD, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, si leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikat profesionale, punët

	<p>laboratorike, detyrat e projektet e kursit etj. Në takimin me studentët gjatë vizitës në institucion, ata konfirmuan përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies nga pedagogët në përputhje me parashikimet e syllabuseve të lëndëve si prezantime me poëerpoint, prezantimi i rasteve studimore, ndarja në grupe pune etj.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe takimi me Dekanin, Shefin e Departamentit dhe stafin, u konstatua puna e vazhdueshme përmes shumë hallkave dhe metodave, për trajnimin e stafit të ri dhe përmirësimin e përbashkët të procesit të mësimdhënies.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.06 Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.pdf</i></p> <p><i>Nr.06.1 Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD (2016-2020).pdf</i></p> <p><i>Nr.10 Rregullore e programi te studimit Infermieri e pergjithshme.pdf</i></p> <p><i>Nr.137 Marrëveshje me Clean Score. trajnimi Clean Score.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Monitorimi dhe vlerësimi periodik i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet nga bashkëpunimi mes strukturave si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë (DKSC); - Zv/Rektori për Mësimin; - Drejtuesi i Departamentit, i cili është përgjegjës për programin e studimit. - Dekani i Fakultetit përgjegjës <p>Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve në fund të çdo semestri, formularët e vetvlerësimit, si dhe analizat e ecurisë të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Universiteti.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.04 Statuti i UAMD.pdf</i></p> <p><i>Nr.08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale.pdf</i></p> <p><i>Nr.09 Rregullore e Departamentite Shkencave Teknike Mjeksore.pdf</i></p> <p><i>Nr.10 Rregullore e programi te studimit Infermieri e pergjithshme.pdf</i></p>




	<p><i>Nr. 18_Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i></p> <p><i>Nr. 93_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>UAMD sigurohet që të marrë opinionin, sugjerimet dhe rekomandimet e studentëve në fund të çdo semestri duke plotësuar pyetësorët e studentëve në mënyrë që institucioni të ketë mundësinë e njohjes së cilësisë së procesit mësimor; format e ndryshme të mësimdhënies; vlerësimin dhe kontrollin e dijeve; etj në sytin e studentëve.</p> <p>Keto pyetësor zhvillohen 2 herë në vit përmes pyetësorëve përkatës të realizuar nga Drejtoria Kurrikulës dhe Sigurimit të Cilësisë, në nivel institucioni.</p> <p>Gjithashtu, rregullorja e UAMD dhe rregullorja e Fakultetit parashikojnë të drejtën e ankimit për të gjithë studentët lidhur me procesin mësimor dhe rezultatin e kontrollit të dijeve, kundrejt plotësimit të një formulari pranë sekretarisë mësimore që i drejtohet Dekanit të fakultetit sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale.pdf</i></p> <p><i>Nr.11 Rregullore Sistemi brend sigurimi cilesise (NJBSC).pdf</i></p> <p><i>Nr.24 Raporti i sigurimit te cilesise UAMD.pdf</i></p> <p><i>Nr.106 Formular tip vleresim stafi nga studentet.pdf</i></p> <p><i>Nr.107 Anketimi i studenteve.pdf</i></p> <p><i>Nr.107.1 Rezultate anketimi.pdf</i></p> <p><i>Nr.108 Transparenca e Rezultateve te Anketimeve te Studenteve.pdf</i></p> <p><i>Nr. 93_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Nga takimet me stafin e sigurimeve të cilësisë, GVJ konstaton se ka një qëndrueshmëri në ruajtjen e cilësisë së stafit akademik në drejtim të procedurave të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Për sa i përket nivelit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, është përgjegjësi i departamentit i cili duhet të marrë masa aktive dhe të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme. Drejtuesi i departamentit i komunikon</p>

	<p>individualisht secilit anëtar të stafit akademik rezultatin e vlerësimit.</p> <p>Në përputhje me parashikimet në rregulloren përkatëse, Drejtoria e Kurrikulës dhe Sigurimit të Cilësisë përgatit raportin vjetor që vlerëson cilësinë e veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore në nivel të brendshëm, sipas kërkesave ligjore dhe nënligjore dhe ja përcjell për shqyrtim dhe miratim NjSBC-së, i cili i propozohet Senatit Akademik për miratim nga KPGS. Këto raporte bëhen pjesë edhe e analizave vjetore që realizohen në nivel departamenti dhe fakulteti.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.11 Rregullore Sistemi brend sigurimi cilesise (NJBSC).pdf</i></p> <p><i>Nr.24 Raporti i sigurimit te cilesise UAMD.pdf</i></p> <p><i>Nr.106 Formular tip vleresim stafi nga studentet.pdf</i></p> <p><i>Nr.107 Anketimi i studenteve.pdf</i></p> <p><i>Nr.107.1 Rezultate anketimi.pdf</i></p> <p><i>Nr.108 Transparenca e Rezultateve te Anketimeve te Studenteve.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, dhe nga dokumentacioni i marrë në dorëzim, rezulton se IAL punon në drejtim të përmirësimit të aftësisë të personelit akademik, duke e nxitur atë në kërkim shkencor në mënyra të ndryshme. Gjithashtu UAMD përdorur instrumenta të kontrollit të cilësisë për vlerësimin e mësimdhënies së stafit akademik. GVJ konstatoi gadishmërinë e drejtuesve të institucionit për të promovuar personelin akademik dhe për të asistuar në drejtim të kualifikimit të mëtejshëm nëpërmjet ofrimit të trajnimeve brenda dhe jashtë vendit dhe pjesëmarrjes në konferenca dhe projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD ka hartuar politika dhe udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie. Nga takimet me stafin e sigurimeve të cilësisë, GVJ konstaton se ka një qëndrueshmëri në ruajtjen e cilësisë së stafit akademik në drejtim të procedurave të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</i></p> <p><i>Kuadri rregullator i UAMD u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi mësimdhënien dhe parashikon të drejtën e studentëve për</i></p>




	<p><i>ankim dhe zgjidhje. Monitorimi dhe vlerësimi periodik i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet nga bashkëpunimi mes strukturave, dhe Mekanizimat kryesorë të monitorimit periodik janë: Vlerësimi i pedagogëve nga studentët në fund të çdo semestri, formularët e vetvlerësimit të stafit akademik, rezultatet e të cilëve përfshihen në analizat vjetore të realizuara në nivel departamenti, fakulteti dhe institucioni. UAMD angazhohet për nxitjen dhe promovimin e pedagogëve përmes pjesëmarrjes në trajnime dhe projekte të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Siç përcaktohet në Statutin e UAMD, neni 77, institucioni harton politika dhe procedura për sigurimin e cilësisë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Këto politika dhe procedura, ndiqen dhe implementohen nga dy strukturat përgjegjëse që janë Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm për garantimin e standarteve dhe cilësisë së intitucionit. Nëpërmjet sigurimit të brendshëm të cilësisë kryhet vlerësimi dhe garantimi i cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të institucionit. Rrjeti i sigurimit të cilësisë sigurohet nga:</p> <p>Strukturat hirearkike organizative të brendshme të UAMD, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave, strategjive dhe procedurave për realizimin e vizionit të tij. Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Komisionin e Përhershëm për garantimin e standarteve dhe cilësisë së intitucionit. Në mënyrë më të detajuar, rregullorja e sigurimit të cilësisë parashikon strukturat e mëposhtme për sigurimin e brendshëm të cilësisë: Në nivel institucional, Senati Akademik, Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC), Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC), Koordinatorin Institucional</p>

	<p>pranë ASCAL (KIAL), Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC).</p> <p>Në nivel fakulteti, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBSC Fakulteti), Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program, koordinatorët e programeve.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.04 Statuti i UAMD.pdf</i></p> <p><i>Nr.11 Rregullore Sistemi brend sigurimi cilesise (NJBSC).pdf</i></p> <p><i>Nr.24 Raporti i sigurimit te cilesise UAMD.pdf</i></p> <p><i>Nr.60 Urdher per ngritjen e komisionit te vleresimit te brendeshem te cilësisë në FSP.pdf</i></p> <p><i>Nr.61 Procesverbal mbledhje Komisionit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në FSP - 2021.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>UAMD ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Cilësisë dhe Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë me qëllim sigurimin e cilësisë. NjSBC funksionon bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin e Institucionit, Rregulloret specifike si dhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë. Bazuar në strategjinë e institucionit, UAMD është i përkushtuar për të siguruar cilësi dhe kërkon të promovojë kulturën e vëmendjes ndaj cilësisë midis studentëve, stafit akademik dhe atij administrativ.</p> <p>Misioni kryesor i NjBSC është planifikimi i përmirësimit të vazhdueshëm të UAMD dhe realizimi i proceseve që e garantojnë këtë përmirësim. Procesi i përmirësimit të vazhdueshëm mundësohet nga angazhimi i të gjitha palëve të përfshira në systemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Sipas rregullores së sigurimit të brendshëm të cilësisë, NjSBC ngrihet me urdhër të rektorit dhe ka shtatë anëtarë, nga të cilët, një përfaqësues nga stafi akademik i çdo fakulteti të UAMD-së, drejtuesi i Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë në Rektorat, si dhe një student.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.04 Statuti i UAMD.pdf</i></p> <p><i>Nr.06 Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.pdf</i></p> <p><i>Nr.06.1 Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD (2016-2020).pdf</i></p> <p><i>Nr.11 Rregullore Sistemi brend sigurimi cilesise (NJBSC).pdf</i></p>

	<p><i>Nr.15 Rregullore e Zyrës së Monitorimit të Kurrikulës.pdf</i></p> <p><i>Nr.24 Raporti i sigurimit te cilesise UAMD.pdf</i></p> <p><i>Nr.60 Urdher per ngritjen e komisionit te vleresimit te brendeshem te cilesise ne FSP.pdf</i></p> <p><i>Nr.61 Procesverbal mbledhje Komisionit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në FSP - 2021.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>UAMD i është nënshtruar procesit të akreditimit të jashtëm në bazë të parashikimeve dhe përcaktimeve ligjore si dhe ka kryer procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit institucional të zhvilluar nga ASCAL. UAMD është akredituar në vitin 2016 për herë të parë, për katër vite akademike dhe në vitin 2022 për herë të dytë me vendim të Bordit të Akreditimit nr. 18, datë 24.03.2022 me vlerësim pozitiv dhe kohëzgjatje 4vite, me afat vlefshmërie deri në 23.03.2026. Ky program studimi po i nënshtrohet për herë të parë procesit të akreditimit.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 133_Vendim Nr. 10 datë 07.04.2017 Për Akreditimin e Parë të IAL Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p> <p><i>Nr. 192_Vendim Nr.18, datë 24.03.2022 i Bordit të Akreditimit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Monitorimi dhe vlerësimi periodik i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet nga bashkëpunimi mes strukturave, të cilat aplikojnë forma të ndryshme të vlerësimit, në bazë të të cilave mund të llogariten tregues të matshëm. Një instrument shumë i rëndësishëm, tregues i drejtpërdrejtë i matjes së cilësisë është pyetësi i zhvilluar me studentët. Bazuar në rregulloren e sigurimit të cilësisë (Aneksi II), sigurimi i cilësisë matet përmes të dhënave dhe treguesve të ndryshëm cilësorë dhe sasiorë të cilët analizohen dhe rishikohen nga strukturat e brendshme të sigurimit të cilësisë në shumë nivele dhe bëhen objekt diskutimi i analizës vjetore në vilët njësie bazë, kryesore dhe institucioni.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.11 Rregullore Sistemi brend sigurimi cilesise (NJBSC).pdf</i></p> <p><i>Nr.24 Raporti i sigurimit te cilesise UAMD.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni në bazë të parashikimeve ligjore dhe akteve rregullatore ka ngritur dhe ka në funksion strukturat për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel institucioni dhe njësie kryesore, përkatësisht DKSC dhe NJSBC, duke</i></p>

	<i>përcaktuar qartë në rregulloren përkatëse detyrat dhe përgjegjësitë e secilës prej tyre. Monitorimi dhe vlerësimi periodik i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet përmes disa mekanizmave. Aktet rregullatore përcaktojnë procedurat, instrumentet dhe indikatorët e sigurimit të brendshëm të cilësisë. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe takimet e kryera me stafin e sigurimit të cilësisë, GVJ konstaton se UAMD ka ngritur struktura dhe hartuar politika/procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Monitorimi dhe vlerësimi periodik i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet përmes disa mekanizmave, si: Vlerësimi i pedagogëve nga studentët; Raporti i vetëvlerësimit në fillim dhe në fund të vitit; dhe Analizat e ecurisë të realizuara në nivel Departamenti të cilat janë pjesë e raporteve vjetore. Rregullorja e sigurimit të cilësisë të UAMD, përcakton qartë proceset dhe mekanizmat që përdoren nga institucioni me qëllim akreditimin. Pas dorëzimit të kërkesës së bashku me formularin për akreditim pranë Ascal, nis procesi i vlerësimit të brendshëm si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm i cili ngrihet nga titullari i njësisë; - Trajnimi i GVB nga stafi i ASCAL; për këtë vihen në dispozicion materialet udhëzuese për vlerësimin, organizimin e grupit dhe procesin, detyrat, të drejtat e përgjegjësitë e secilit; - Kryerja e vlerësimit të brendshëm sipas udhëzuesve. Gjatë kësaj faze GVB qëndron në kontakt të vazhdueshëm me ASCAL dhe asistohet nga kjo e fundit në rast kërkese; - Përgatitja e Dosjes së Vetëvlerësimit;

	<ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) sipas kërkesave e udhëzimeve dhe pas konsultimit të përmbajtjes së tij me stafin e njësisë; - Dorëzimi në ASCAL i RVB <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se UAMD përdor mekanizma e procese të dokumentuara për shqyrtimin, vlerësimin, miratimin periodik të programeve të studimit. Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë ka për detyrë rishikimin periodik të programit të studimit duke specifikuar edhe elementët të cilëve duhet ti kushtohet vëmendje gjatë procesit të rishikimit. Në këtë proces përfshihen edhe studentët nëpërmjet marrjes së opinionëve të tyre lidhur me zhvillimin e procesit mësimor.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr. 18_Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i></p> <p><i>Nr.11 Rregullore Sistemi brend sigurimi cilesise (NJBSC).pdf</i></p> <p><i>Nr.15 Rregullore e Zyrës së Monitorimit të Kurrikulës.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, rezultoi se në mbledhjet e departamentit në fund të çdo viti mësimor analizohet ecuria dhe mbarëvajtja e gjithë procesit mësimor, si dhe problematikat e evidentuara nga pyetësorët e studentëve. Ky informacion përfshihet në raportin e analizës vjetore të veprimtarisë së departamentit që u komunikohet strukturave të UAMD sipas parashikimeve të kuadrit rregullator përkatës.</p> <p>Komisioni i vlerësimit të brendshëm të cilësisë në bashkëpunim me NjSBC në bazë të raporteve jep rekomandime/sugjerime për përmirësimin e pikave të dobëta që ka Institucioni. NjSBC është në komunikim të vazhdueshëm me departamentet përkatëse dhe e gatshme për implementimin e përmirësimin e praktikave mësimore. Instrumentet e shumta si pyetësorë me studentët, stafin akademik, fokus grupet, etj. shërbejnë për marrjen e një feedback-u me qëllim ndërhyrjen dhe përmirësimin e cilësisë nëse është e nevojshme.</p>
	<p>GVJ konstaton se ka mangësi në vlerësimin e performancës së programit dhe stafit, rezultateve të pritshme, problematikave të ndeshura gjatë vitit akademik të rezultuara nga zbatimi i instrumenteve të</p>




	<p>sigurimit të cilësisë. Këto rezultate nuk shoqërohen me anallizë performancerekomandime dhe plan masash konkrete për trajtimin e mangësive dhe përmirësim të mëtejshëm.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.64 Raport Vjetor UAMD 2020-2021.pdf</i></p> <p><i>Nr.65 Raporti i Vetëvlerësimit UAMD - 2021.pdf</i></p> <p><i>Nr.24 Raporti i sigurimit te cilesise UAMD.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>UAMD, në kuadër të vlerësimit dhe realizimit për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta nëpërmjet të cilave merr informacion mbi vlerësimin e kurrikulave, planit mësimor, metodave didaktike të mësimdhënies, vlerësimin e ecurisë dhe angazhimit të studentëve në programin e studimit, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i pedagogëve nga studentët • Raporti i vetëvlerësimit • Analizat e ecurisë <p>Rregullorja e sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë parashikon instrumenta të ndryshëm për sigurimin e cilësisë në drejtim mësimdhënies, shërbimeve që ofron institucioni, cilësisë së programeve të studimit, cilësisë së studentëve, të personelit dhe të kërkimit shkencor. Dekani i Fakultetit si autoriteti më i lartë drejtues, ushtron kontroll rreth veprimtarisë administrative, akademike dhe shkencore në të gjitha njësitë e fakultetit. Kështu, secili departamentet më në krye përgjegjësit respektivë, ushtron kontrole periodike për ecurinë e procesit mësimor. Angazhimet në ndjekjen e një leksioni të hapur nga lektorët, rishikimi periodik i literaturës së përdorur, shkëmbimi i eksperiencave jashtë auditorit dhe bashkëpunimin për ndërthurjen e lëndëve mësimore janë praktika promovuese ndaj shkëmbimit të eksperiencave të punës ndarmjet lektoreve dhe specialistëve të spikatur të fushave. Të gjitha këto forma të kontrollit janë në kuadër të promovimit të mësimdhënies sa më cilësore dhe përmirësimit të marrëdhënieve studentë-pedagogë.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.64 Raport Vjetor UAMD 2020-2021.pdf</i></p> <p><i>Nr.65 Raporti i Vetëvlerësimit UAMD - 2021.pdf</i></p> <p><i>Nr.24 Raporti i sigurimit te cilesise UAMD.pdf</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Zyra e Alumni dhe Karrierës në kuadër të vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit, realizon sondazhe të studentëve nëpërmjet pyetësorëve që plotësohen në fund të çdo semestri akademik nga studentët aktualë si dhe gjurmimin e studentëve të diplomuar nëpërmjet pyetësorëve ose intervistave që zhvillohen gjatë panairit të punës. Pyetësori i studentit vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie, duke vlerësuar karakteristika që lidhen me aftësitë komunikuese dhe profesionale të pedagogut, etikën, metodat inovative të përdorura, korrektesën, vlerësimet e dijeve të studentit etj. Rezultatet e vlerësimit bëhen transparente dhe i vihen në dispozicion individualisht, të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësive të departamentit, si dhe dekanit nga DKSC në Rektorat. Vlerësimi i cilësisë së shërbimeve të institucionit (UAMD) sigurohet nëpërmjet pyetësorit të studentëve, pyetësorit të stafit akademik, pyetësorit të stafit administrativ, vlerësimit të drejtuesit të njësisë kryesore për stafin administrativ që ai drejton.</p> <p>Megjithatë GJV konstaton se analiza dhe vlerësimi nëpërmjet pyetësorëve është e limituar dhe nuk kryhet në mënyrë periodike. Rezultatet nuk shoqërohen me rekomandime dhe veprime konkrete në kuadër të përmirësimit.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.12 Rregullore e Sektorit te Komunikimit, Alumnit dhe Karrieres.pdf</i></p> <p><i>Nr.39 Shoqata Alumni UAMD.pdf</i></p> <p><i>Nr.64 Raport Vjetor UAMD 2020-2021.pdf</i></p> <p><i>Nr.65 Raporti i Vetëvlerësimit UAMD - 2021.pdf</i></p> <p><i>Nr.24 Raporti i sigurimit te cilesise UAMD.pdf</i></p> <p><i>Nr.86 Model Pyetësori për Studentet e Diplomuar.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka ngritur struktura dhe hartuar politika/procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Monitorimi dhe vlerësimi periodik i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet përmes disa mekanizmave. - Instrumentet e shumta si pyetësorë me studentët, stafin akademik, fokus grupet, etj shërbejnë për marrjen e një feedback-u me qëllim ndërhyrjen dhe përmirësimin e cilësisë nëse është e nevojshme. Përdor mekanizma dhe procese formale për monitorimin dhe vlerësimin e programeve të</i></p>

	<p><i>studimit, Megjithatë GVJ konstaton se analiza dhe vlerësimi nëpërmjet pyetësorëve është e limituar dhe nuk kryhet në mënyrë periodike. Rezultatet nuk shoqërohen me rekomandime dhe veprime konkrete në kuadër të përmirësimit. GVJ konstaton se rezultatet e vlerësimeve bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe merren në konsideratë për adresimin e problematikave të evidentuara, planin e masave për përmirësim dhe motivimin e praktikave më të mira. GVJ mendon se ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UAMD ka ngritur struktura në nivel institucioni dhe njësie kryesore të cilat kanë për detyrë të garantojnë politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë duke përfshirë personelin e brendshëm akademik dhe administrativ, studentët si dhe aktorë të jashtëm si lektorë të ftuar apo bashkëpunëtorë në projekte të ndryshme, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Njësitë funksionojnë bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin e Institucionit si dhe Rregulloret e brendshme specifike.</p> <p>Rregullorja e sigurimit të cilësisë përcakton ngritjen e strukturave të posacme të sigurimit të cilësisë si: Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC), Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) në nivel institucioni dhe njësie kryesore, Koordinatori Institucional pranë ASCAL (KIAL), Drejtorja e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC).</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.04 Statuti i UAMD.pdf</i></p> <p><i>Nr.11 Rregullore Sistemi brend sigurimi cilesise (NJBSC).pdf</i></p> <p><i>Nr.15 Rregullore e Zyrës së Monitorimit të Kurrikulës.pdf</i></p>

	<p><i>Nr.60 Urdher per ngritjen e komisionit te vleresimit te brendshem te cilesise ne FSP.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Statuti (kreu VII), rregullorja e sigurimit të cilësisë (nenet 10, 11 dhe 12) përcakton strukturat përgjegjëse për vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë të programit të studimit si dhe të gjitha organet, duke specifikuar detyrat dhe përgjegjësitë për secilin prej tyre.</p> <p>Senati si organi më i lartë akademik ka përgjegjësinë përfundimtare për miratimin, monitorimin dhe rishikimin e të gjitha procedurave të sigurimit të cilësisë. Komisioni dhe njësia varen nga senati dhe çdo propozim ia drejtojnë senatit. Komisioni ka ndihmuar në inkorporimin e praktikave ekzistuese me praktikat e reja. Komisioni ka pasur rol aktiv në hartimin e këtyre rregulloreve, të cilat më pas i ja</p> <p>GVJ konstaton se studentët janë të përfaqësuar në NJSBC si edhe si anëtar të GVB së programit të studimit.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.04 Statuti i UAMD.pdf</i></p> <p><i>Nr.11 Rregullore Sistemi brend sigurimi cilesise (NJBSC).pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>UAMD siguron cilësinë e programeve të studimit nëpërmjet punës së bashkërenduar të NJSBC dhe Komisionit me qëllim sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxenie. Fakulteti ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila ka për detyrë të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore.</p> <p>Në nivel fakulteti përgjegjës për sigurimin e standardeve të cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve • Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program • Koordinatorët e Programeve <p>NJBSC në nivel fakulteti, realizon në mënyrë autonome objektivat dhe masat e vendosura nga NJBSC ne nivel Institucional. Për realizimin e objektivave të akreditimit NJBSC në nivel Fakulteti bashkëpunon me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm për programet e studimit, duke u koordinuar nga NJBSC në nivel institucional. I gjithë personeli akademik dhe administrativ ka rol të rëndësishëm në menaxhimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të</p>

	<p>cilësisë, përmes një bashkëpunimi të vazhdueshëm me strukturat përgjegjëse të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.11 Rregullore Sistemi brend sigurimi cilesise (NJBSC).pdf</i> <i>Tabelat ASCAL dega bachelor Infermieri e pergjithshme.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se pyetësorët dhe mekanizmat e tjerë të përdorur në procesin e sigurimit të cilësisë nuk çenojnë lirinë akademike dhe integritetin akademik të personelit dhe studentëve si dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Ruhet privatësia e informacionit dhe e rezultateve që sigurohen nga veprimtaria e tyre dhe anonimati i studentëve që plotësojnë formularët e vlerësimit.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.11 Rregullore Sistemi brend sigurimi cilesise (NJBSC).pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Roli i bashkëpunëtorve të jashtëm qëndron në bërjen e opionencës së brendshme të procesit si dhe ndihmon në hartimin e rregullores, statutit, rishikimin e pyetësorit si dhe mundësojnë realizimin e leksioneve të hapura me lektorë të ftuar, pjesëmarrjen e bizneseve të ndryshëm në panairët e punës, si dhe realizimin e praktikave profesionale të studentëve. Nëpërmjet këtyre bashkëpunimeve, përfaqësues të biznesit apo institucioneve të tjera arsimore brenda dhe jashtë vendit, japin mendimet e tyre lidhur me cilësinë e programit të studimit dhe përmirësimin e tij.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD ka ngritur struktura dhe ka hartuar politika/procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Aktet rregullatore lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë të UAMD, përcaktojnë qartë strukturat dhe njësitë që angazhohen në këtë proces. UAMD siguron përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit. Përfshirja e bashkëpunëtorëve dhe/ose ekspertëve të jashtëm bëhet nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme që organizohen nga institucioni. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>UAMD ka hartuar politikat dhe procedurat në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të gjitha programet e studimit dhe i ka dokumentuar ato në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë, Statutin dhe Rregulloren e UAMD, të cilat janë të disponueshme për të gjitha palët e interesit si dhe studentët informohen vazhdimisht nga personeli akademik dhe strukturat e institucionit.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.04 Statuti i UAMD.pdf</i></p> <p><i>Nr.10 Rregullore e programi te studimit Infermieri e pergjithshme.pdf</i></p> <p><i>Nr.11 Rregullore Sistemi brend sigurimi cilesise (NJBSC).pdf</i></p> <p>https://www.uamd.edu.al</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit analizohen gjatë analizave vjetore në Departament dhe bëhen pjesë e Analizës së Veprimtarive Mësimore dhe Kërkimore të Fakultetit dhe sipas akteve rregullatore përfshihen në raportet periodike të Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë në nivel rektorati. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se publikimet në faqen zyrtare web të UAMD përsa i përket rezultateve të vlerësimit të pedagogëve nga studentët dhe kolegët adresohen në mënyrë të kujdesshme, duke ruajtur etikën dhe konfidencialitetin. Gjithashtu, vlerësimet e studentëve përpunohen në mënyrë elektronike dhe konkluzionet si dhe komentet u bëhen publike pedagogëve përkatës pasi lënda të ketë përfunduar plotësisht duke ruajtur konfidencialitetin.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.15 Rregullore e Zyrës së Monitorimit të Kurrikulës.pdf</i></p>

	<p><i>Nr.24 Raporti i sigurimit te cilesise UAMD.pdf</i></p> <p><i>Nr.59 Manual për Sistemin e Brendshëm të Sigurimit e Cilësisë në Fakultetin e Studimeve Profesionale, v.a. 2018-2019.pdf</i></p> <p><i>Nr.70. Analiza vjetore e FSP 2020- 2021.pdf</i></p> <p><i>Nr.108 Transparenca e Rezultateve te Anketimeve te Studenteve.pdf</i></p> <p><i>https://www.uamd.edu.al/fea</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>NjSBC është në komunikim të vazhdueshëm me departamentet përkatëse dhe e gatshme për implementimin e përmirësimin e praktikave mësimore. GVJ konstaton se rezultatet e vlerësimit kur ai kryhet, u bëhen të njohura stafit akademik dhe sipas RVB merren në konsideratë për marrjen e masave për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit. Nga shqyrtimi i evidencave dhe dokumentacionit shoqëruar të RVB, GVJ nuk konstaton hartimin e një plani masash që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.15 Rregullore e Zyrës së Monitorimit të Kurrikulës.pdf</i></p> <p><i>Nr.24 Raporti i sigurimit te cilesise UAMD.pdf</i></p> <p><i>Nr.70. Analiza vjetore e FSP 2020- 2021.pdf</i></p> <p><i>https://www.uamd.edu.al/fea</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se UAMD, ka krijuar kulturën e vlerësimit, përmes ndërgjegjësimit të të gjithë aktorëve. Departamenti përgjegjës për këtë program studimi analizon periodikisht ecurinë dhe problematikat e procesit mësimor, punën kërkimore-shkencore, angazhimin administrativ, aktivitetet me studentët si dhe përcaktohen objektivat për vitin e ardhshëm akademik në funksion të përmirësimin të vijueshëm të cilësisë. Gjatë vizitës në insitucion GVJ konfirmoi angazhimin ne përmirësimin e programit te studimit në kuadër të monitorimit dhe sigurimit të cilësisë.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Nr.15 Rregullore e Zyrës së Monitorimit të Kurrikulës.pdf</i></p> <p><i>Nr.24 Raporti i sigurimit te cilesise UAMD.pdf</i></p> <p><i>Nr.70. Analiza vjetore e FSP 2020- 2021.pdf</i></p>

	<i>Vizita në Institucion</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Referuar RVB dhe dokumentacionit në dispozicion, UAMD harton raportin vjetor mbi cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, i cili u vihet në dispozicion stafit akademik dhe administrativ. NjsBC dhe Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Cilësisë bashkëpunojnë ngushtë me qëllim përditësimin e vijueshëm të të gjithë palëve të interesit dhe për të nxitur pjesëmarrjen aktive të tyre në procesin e përmirësimit afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit. Gjithashtu drejtuesit e institucionit dhe strukturave përgjegjëse zhvillojnë vazhdimisht takime me personelin akademik për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Evidenca: <i>Nr.24 Raporti i sigurimit te cilesise UAMD.pdf</i> <i>Nr.70. Analiza vjetore e FSP 2020- 2021.pdf</i>			
Konkluzione	<i>UAMD ka hartuar politikat dhe procedurat në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të gjitha programet e studimit, të cilat janë transparente dhe të aksesueshme nga studentët dhe palët e interesuara. Informacioni i publikuar në faqen zyrtare të internetit, përfshirë edhe raportet vjetore, nuk është gjithmonë dhe qartësisht i aksesueshëm. Rezultatet e vlerësimit të pedagogëve nga studentët dhe kolegët adresohen në mënyrë të kujdesshme, duke ruajtur etikën dhe konfidencialitetin. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Numër i lartë i studentëve të regjistruar në këtë program studimi;
2. Hartimi i udhëzuesit “Aftësim për mësimdhënie ndërvepruese”;
3. Përdorimi i sistemit CleanScore në korrigjimin e provimeve;
4. Orientimi i studentëve nga stafi akademik për orientimin e studentëve për detyrimet përmbyllëse;
5. Laboratorët janë të pajisur me programe profesionale në mbështetje të kurrikulës së programit.

Pika të dobëta:

1. Studentët nuk kishin njohuri mbi koordinatorin e programit të studimit;
2. Mungesa e mobiliteteve të studentëve në IAL të huaja;
3. Mungesa e përfshirjes së aktorëve të jashtëm dhe studentëve në përditësimin e programit të studimit;
4. Analiza dhe vlerësime të performancës së programit dhe personelit akademik nëpërmjet pyetësorëve apo formave të tjera është e limituar dhe nuk kryhet në mënyrë periodike. Rezultatet nuk shoqërohen me rekomandime dhe veprime konkrete në kuadër të përmirësimit;
5. Mangësi në vlerësimin e performancës së programit dhe stafit.
6. Analiza dhe vlerësimi nëpërmjet pyetësorëve është e limituar dhe nuk kryhet në mënyrë periodike.

Rekomandime:

1. Përpjekje për të rritur numërin e anëtarëve të stafit akademik me tituj akademik dhe grada shkencore;
2. GVB konsideron si të rëndësishme krijimi e një Njësie Kryesore e cila të ketë fokus vetëm Shkencat Mjeksore;
3. Implementimin e marrveshjeve të cilat Njësia Bazë/Kryesore ka nënshkruar me qëllim shfrytëzimin e tyre nga stafi akademik dhe studentët;
4. Hartimin e raporteve mbi ecurinë dhe përfitimet nga marrveshjet e nënshkruara;
5. Përdorimi i formatit të propozuar nga MAS për syllabuset;
6. Dokumentimi i procedurave kur zhvillohet përditësimi i programit të studimit;
7. Rritja e mobiliteteve të studentëve në IAL të huaja;
8. Përditësimi i rregullt i syllabuseve është i nevojshëm si dhe dokumentimi i ndryshimeve të bëra;
9. Përfshirje e alumni në përditësimin e programit të studimit;
10. Hartimi i një plani masash specifike mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve;



11. GVJ konsideron sit ë rëndësishme hartimin e një procedure ku stafi akademik me kontrat me afat të pa caktuar të vlerësohet të paktën një herë në vit nga Drejtuesi i Njësisë Bazë;
12. Përdorimi i ndonjë sistemi antiplagjiature nga Njësia Bazë;
13. Përfshirja në planin mësimor të lëndëve si Informatikë Shëndetësore Komunikimin efektiv midis mjek/infermier/pacient;
14. Të kryhen analiza dhe vlerësime të performancës së programit dhe personelit akademik në mënyrë periodike duke i shoqëruar me rekomandime dhe veprime konkrete në kuadër të përmirësimit.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Nursing" provided by the Higher Education Institution Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës

Strengths and affirmations

1. High number of students enrolled in this study program;
2. Drafting of the guide "Ability for interactive teaching";
3. Use of the CleanScore system in the correction of exams;
4. Orientation of students by the academic staff for the orientation of students for the final obligations;
5. The labs are equipped with professional programs in support of the program curriculum.

Weaknesses

1. The students had no knowledge about the coordinator of the study program;
2. Lack of student mobility in foreign HEIs;
3. Lack of involvement of external stakeholders and students in updating the study program;
4. Analysis and evaluation of the performance of the program and the academic staff through questionnaires or other forms is limited and is not carried out periodically. The results are not accompanied by concrete recommendations and actions in the framework of the improvement;
5. Shortcomings in program and staff performance evaluation.
6. Analysis and evaluation through questionnaires is limited and not carried out periodically.

Recommendation

1. Efforts to increase the number of academic staff members with academic titles and scientific degrees;
2. GVB considers it important to create a Main Unit which focuses only on Medical Sciences;
3. Implementation of the agreements which the Basic/Main Unit has signed in order to use them by the academic staff and students;
4. Drawing up reports on the progress and benefits from the signed agreements;
5. Using the format proposed by MAS for syllabuses;
6. Documentation of the procedures when updating the study program;
7. Increasing the mobility of students in foreign HEIs;



8. Regular updating of syllabuses is necessary as well as documentation of the changes made;
9. Involvement of alumni in updating the study program;
10. Designing a plan of specific measures on the results of the student questionnaire;
11. GVI considers it important to design a procedure where the academic staff with an indefinite term contract is evaluated at least once a year by the Head of the Basic Unit;
12. Use of any anti-plagiarism system by the Base Unit;
13. Inclusion in the curriculum of subjects such as Health Informatics Effective communication between doctor/nurse/patient;
14. Analyzes and evaluations of the performance of the program and the academic staff are carried out periodically, associating them with concrete recommendations and actions in the framework of improvement.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

